

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E enjte, 2 shtator 2021

2 [Konferencë përgatitore për gjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk marrin pjesë]

5 --- Fillon në orën 09.30

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
7 Gjykatës. Lënda KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar  
8 kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk ju thashë mirëmëngjes  
10 askujt, po ju them tani të gjithëve të gjithëve, mirëmëngjes.

11 Prokuroria dhe Mbrojtja u prezantuan dje. Nuk kam  
12 ndërmend që të kërkoj prej tyre të prezantohen përsëri, në  
13 qoftë se është dikush i ri që është në ekipet tuaja, atëherë  
14 prezantohuni ju vetë.

15 Z. Rees.

16 Z. REES: [Përkthim] Me mua sot është edhe znj. Victoria  
17 Maud.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Po tek Zyra Administrative a është dikush i ri, i  
20 pranishëm?

21 Z. ROCHE: [Përkthim] Unë jam Ralph Roche nga Zyra  
22 Administrative. Me mua sot është edhe Stephane.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Sot do të përfundojmë rendin e ditës të përcaktuar në  
25 urdhrin e datës 21 korrik. Pastaj do të dëgjojmë palët në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 lidhje me listën sipas rregullit 102(3) dhe, në qoftë se ka  
2 nevojë do të shkojmë në seancë *ex-parte*. Në qoftë se do të  
3 shkojmë në seancë *ex-parte*, atëherë do të bëjmë një pushim 30  
4 minutësh, që t'i mundësojmë teknikëve të bëjnë përgatitjet e  
5 duhura.

6 Pas pushimit të drekës, do të mblidhemi përsëri në mënyrë  
7 që Trupi Gjykses të nxjerrë disa urdhra me gojë.

8 Pika e parë e sotshme ka të bëjë me natyrën konfidenciale  
9 ose jopublike të materialit që të akuzuarit pretendohet të  
10 kenë bërë publik. Fjalën do t'ia jap gjykatësit Barthe për të  
11 bërë pyetje në lidhje me këtë pikë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.

13 Në urdhrin 21 korrikut, paragrafit 24, Trupi Gjykses vuri  
14 në dukje kundërshtimin e ngritur në dosjen paraprake të  
15 Mbrojtjes së Gucatit në lidhje me natyrën konfidenciale ose  
16 jopublike të materialit që pretendohet se është bërë publik  
17 nga të akuzuarit. Trupi Gjykses ftoi palët që të bëjë  
18 parashtrime gojore në lidhje me natyrën jopublike ose  
19 jokonfidenciale të materialeve që pretendohet se i nxorën të  
20 akuzuarit.

21 Tani do të pyes, fillimisht Mbrojtjen, duke filluar me  
22 Mbrojtjen e z. Gucati, të qartësojnë nëse, sipas saj,  
23 materiali tashmë ishte pjesërisht ose tërësisht i njohur për  
24 publikun dhe nëse po, cila ose cilat pjesë për ndonjë arsye  
25 tjetër materiali nuk ishte status konfidencial ose të mbrojtur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 sipas sistemit të zbatueshëm ose ZPS-ja nuk vërtetoi se  
2 materiali kishte një status të tillë të mbrojtur.

3 Më pas do të ftoj ZPS-në që të përgjigjet.

4 Urdhëroni z. Rees keni fjalën.

5 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 Qëndrimi është ky, informacioni fillimisht ka qenë pjesërisht  
7 ose tërësisht i njohur për publikun. Kjo është pranuar në  
8 pjesë të madhe në lidhje me paketën 2 nga ZPS-ja dhe në dosjen  
9 paragjyqësorit të Mbrojtjes janë identifikuar edhe pjesët e  
10 tjera të informacionit nga paketat që na janë dhënë.

11 E dyta, ZPS-ja nuk ka vërtetuar për mendimin tonë  
12 statusin e mbrojtur konfidencial ose jopublik të dokumenteve.  
13 Këtu përfshihet edhe pretendimi jonë se ZPS-ja nuk ka  
14 vërtetuar se ky material kishte status të mbrojtur sipas  
15 sistemit të zbatueshëm të statusit konfidencial.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit, z. Rees.

17 A keni diçka për të shtuar z. Cadman?

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne gjatë të gjitha fazave i kemi  
19 mbështetur qëndrimet e z. Rees. Duke qenë se nuk kemi pasur  
20 mundësi që ta analizojmë atë material, ne nuk jemi dhe në  
21 gjendje të japim një mendim më të hollësishëm lidhur me këtë.

22 Gjatë të gjitha fazave, kemi thënë edhe në procesverbal,  
23 se ZPS-ja ka detyrën e provës për të hetuar konfidencialitetin  
24 ose natyrën jopublike të atij materiali dhe ky vazhdon të jetë  
25 qëndrimi jonë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 4

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

2 Prokurori, z. Halling, keni diçka për të shtuar, për t'u  
3 përgjigjur?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

5 Të gjitha që përmenden brenda paketave të materialeve  
6 janë material i mbrojtur sidomos kjo përmendet në paragrafin  
7 37 të vendimit të konfirmimit.

8 Sikurse thashë dje, çdo gjë që tha Mbrojtja dje vërtetoi  
9 se ata e kanë të qartë që materialet që janë dorëzuar janë  
10 konfidenciale. Kundërshtimet e Mbrojtjes së Gucatit kanë të  
11 bëjnë, së pari, me klasifikimin e dokumenteve që janë dorëzuar  
12 dhe autenticitetin e tyre, mirëpo ZPS-ja do të paraqesë do të  
13 paraqesë prova gjatë gjyimit që do të vërtetojnë se  
14 materialet e dorëzuara ishin të klasifikuara si konfidenciale.

15 Gjykatësit do të dëgjojnë dëshmi në lidhje me pjesë të  
16 këtyre dokumenteve që ju treguan mediave dhe mendoj që  
17 Mbrojtja e Gucatit kur thotë për këtë kundërshtim e ka  
18 parasysh mënyrën e përgjithshme sesi kanë qenë të renditura  
19 dokumentet.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit. Z. Mettraux  
21 tha që ka disa pyetje.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

23 Z. Rees, ka një zonë ngjyrë hiri në dosjen paraprake  
24 tuaj. E di që kundërshtoni natyrën konfidenciale të  
25 materialit.

1 Po e lë anash këtë një herë, por Prokuroria mbështetet  
2 dhe kjo u tha disa sekonda përpara dhe klienti juaj z. Cadman,  
3 ishin në dijeni se materialet ishin të natyrës konfidenciale  
4 dhe në dosjen paraprake të Prokurorisë në mbështetje të kësaj  
5 përmenden disa prova, sipas të cilave edhe z. Gucati edhe z.  
6 Haradinaj janë referuar atij materialei si material  
7 konfidencial dhe/ose i fshehtë.

8 Dhe dua të di nëse ky vazhdon të jetë qëndrimi juaj  
9 lidhur me këtë pjesë të provave të Prokurorisë. Nëse nuk doni  
10 ta bëni këtë, kjo sigurisht që është vendimi juaj. Mirëpo duam  
11 që të na ndihmoni në mënyrë që ne ta kuptojmë drejtë qëndrimin  
12 që keni ju dhe pastaj do t'i drejtohem z. Cadman me të njëjtën  
13 pyetje.

14 Z. REES: [Përkthim] Do t'ju ndihmoj në këtë aspekt, i  
15 nderuar Gjykatës. Komentet që ju atribuohen të akuzuarve duhet  
16 të interpretohen brenda një konteksti dhe të akuzuarit e kanë  
17 bërë të qartë qëndrimin e tyre se ata nuk e kanë ditur që  
18 natyra e këtyre dokumenteve ishte konfidenciale apo në qoftë  
19 se këto dokumente ishin autentike apo false.

20 Z. Gucati nuk është avokat, nuk është jurist dhe ato  
21 duhet të shihen dhe të pranohen si të tilla, pra, si komente  
22 të bëra nga një person që nuk është jurist. Nuk është bërë  
23 nxjerrja e këtyre materialeve. Dhe për këtë arsye, ne  
24 mbështetemi në qëndrimin që e kemi paraqitur edhe në dosjen  
25 paragjyqësore. Të akuzuarit nuk e kanë ditur në qoftë se këto

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 materiale kanë qenë autentike apo të fabrikuara.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Cadman, në qoftë se  
3 keni parashtrime të ngjashme me z. Rees, atëherë këto i dimë  
4 tani. A ndryshon qëndrimi juaj në ndonjë aspekt?

5 Z. CADMAN: [Përkthim] Qëndrimi jonë, thënë shkurt, është  
6 i ngjashëm me atë të z. Rees. Sipas nesh, Trupi Gjykses do të  
7 duhet t'i shikojë të gjitha ato videoincizime dhe të gjitha  
8 konferencat për shtyp dhe të gjitha komentet e bëra në media  
9 dhe ato t'i bëjë brenda një konteksti.

10 Nuk është e mjaftueshme për mendimin tonë, që Trupi  
11 Gjykses t'i shqyrtojë në hollësi ato materiale vetëm nga  
12 transkriptet. Duhet t'i shikojë të gjitha ato brenda një  
13 konteksti përpara se të nxjerrë përfundimet e veta.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit z. Cadman.

15 Në qoftë se keni ndërmend të thërrisni klientin tuaj si  
16 dëshmitar, mos harroni që emrin e tij ta vendosni në listën e  
17 dëshmitarëve të pritshëm të Mbrojtjes.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju e dini i nderuar Gjykatës, se  
19 listën që kemi paraqitur është e përkohshme dhe çdo ndryshim i  
20 saj do t'i bëhet i ditur Trupit Gjykses.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 z. Prokuror, a keni përgjigje?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Vetëm shkurtimisht në lidhje me  
24 parashtrimin e z. Rees kur tha se të akuzuarit nuk e kanë  
25 ditur nëse dokumentet janë autentike ose falso. Në paragrafin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 40 të vendimit të konfirmimit përshkruhet synimi i të  
2 akuzuarve në qoftë se ju duhet si referencë gjykatësve.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Pyetja tjetër me radhë ka të  
5 bëjë me kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me elementet e  
6 veprave penale dhe format e përgjegjësisë. Nuk kemi nevojë që  
7 të hyjmë në hollësi në këtë fazë të procesit. Thjesht pyesim  
8 Mbrojtjen nëse ka ndërmend të ngrejë kundërshtime të tilla.  
9 Nuk ka nevojë, siç thashë, të hyjmë në hollësi.

10 Z. Rees, a do të bëni kundërshtime?

11 Z. REES: [Përkthim] Po.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju faleminderit.

13 Pika në vijim është përdorimi i faqes në Facebook, pra,  
14 me parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit të bëra dosjen  
15 paraprake në lidhje me përdorimin e faqes në Facebook. Në  
16 lidhje me këtë pikë, fjalën ja jap gjykatësit Mettraux, i cili  
17 ka pyetje.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit, gjykatësi  
19 Smith.

20 Në urdhrin e 21 korrikut, Trupi Gjykses vuri në dukje  
21 parashtrimin e Mbrojtjes së Gucatit, sipas të cilit: "I  
22 akuzuari pranon se ka pasur një faqe në Facebook në emrin e  
23 tij, në të cilën ai kishte qasje dhe kohë pas kohe e përdorte.  
24 Megjithatë, ai nuk ishte i vetmi që kishte qasje në atë faqe,  
25 ajo përdorej edhe nga OVL-UÇK-ja dhe nga familja për të

1 postuar material”.

2 Në të njëjtin urdhër, Trupi Gjykses bëri të ditur se do  
3 të ftonte Mbrojtjen e Gucatit të shprehet nëse e konteston  
4 pohimin e ZPS-së se postimet e kundërshtuara u postuan nga  
5 vetë Gucati ose me dijeninë e tij në faqen e tij në Facebook.  
6 Z. Rees, urdhëroni t’i përgjigjeni pyetjes së Trupit Gjykses.

7 Z. REES: [Përkthim] Mirëpres këtë ftesë për qartësim.

8 Do të përgjigjem në dy mënyra. Së pari, duke pohuar se  
9 në dosjen tonë paraprake do të gjeni të gjithë materialin në  
10 lidhje me këtë aspekt dhe së dyti, duke pranuar këto  
11 parashtrime që bëtë ju dje, i nderuar Gjykatës, në lidhje me  
12 postimet në Facebook i takon ZPS-së që t’i përjashtojë pra  
13 këto mundësitë t; tjera të postimit dhe ne ja lëmë punën e  
14 vërtetimit asaj.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, në bazë të  
16 qëndrimit tuaj dhe asaj që keni paraqitur në dosjen  
17 paragjyqësore, a do të thotë kjo se ju nuk planifikoni të  
18 thërrisni dëshmitarë apo të paraqisni prova në lidhje me  
19 përdorimin e kësaj faqeje në Facebook dhe se nuk keni ndërmend  
20 të identifikoni asnjë person që mund të ketë pasur qasje në  
21 atë faqe të Facebook-ut gjatë periudhës në fjalë. Me sa ju  
22 kuptuam, ju thoni, se Prokuroria e ka detyrimin e provës në  
23 lidhje me këtë pikë. A ju kam kuptuar drejt?

24 Z. REES: [Përkthim] Po. Detyrimin e provës e ka  
25 Prokuroria. Dhe në lidhje me gjithë elementët në këtë çështje



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 9

1 gjyqësore Prokuroria duhet të provojë çdo akuzë të paraqitur  
2 në Aktakuzë me paraqitjen e provave të veta.

3 Në lidhje me atë që i thatë z. Cadman, në qoftë se z.  
4 Haradinaj do të japë dëshmi gjatë gjykimit, nëse do të ishte  
5 kështu atëherë këto do të përfshihen në listën e dëshmitarëve  
6 të mundshëm. Në qoftë se ka ndonjë ngatërresë në lidhje me  
7 listën do ta qartësoj.

8 Të nderuar Gjykatës, në këtë fazë ne propozojmë që z.  
9 Gucati të ftohet për të dhënë dëshmi në fund të paraqitjes së  
10 provave nga Prokuroria dhe mendojmë se kjo do të qartësojë më  
11 vonë çdo keqinterpretim.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju ndihmon z. Rees  
13 dhe mendoj që Prokuroria do të jetë gjithashtu mirënjohëse, të  
14 na tregoni me kohë nëse do të vendosni se a do ta ftoni ose jo  
15 për të dëshmuar klientin tuaj. Dhe këtë ta bëni në kohën e  
16 duhur.

17 Z. REES: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Cadman urdhëroni.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm të shtoj diçka. Në qoftë se  
20 do të shikoni procesverbalin e këtij procesi, postimet në  
21 Facebook janë disa mijëra faqe materiali dhe duhen rishikuar.  
22 Ne nuk kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me këtë në  
23 dosjen tonë paragjyqësore, por qëndrimi i z. Haradinaj është i  
24 njëjtë si i z. Gucati.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 10

1 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror, a keni diçka për  
2 të shtuar?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, dhe do të jem i shkurtë sepse  
4 e kam prekur këtë temë edhe dje.

5 Prokuroria nuk e mohon se e ka detyrën e provës në këtë  
6 çështje, por është çështje e provave rrethanore se kush i ka  
7 bërë këto postime. Të gjitha provat e disponueshme sikurse u  
8 theksua dje, tregojnë faktin se këto postime u bënë nga vetë  
9 Gucati ose me autorizimin e tij.

10 Mbrojtja nuk e ka për detyrë të paraqesë prova në këtë  
11 gjykim, mirëpo për momentin nuk ekziston ndonjë deduktim  
12 tjetër që mund të nxirret nga provat në lidhje me postimet në  
13 Facebook. Siç thashë edhe dje, për të nxjerrë një përfundim të  
14 dytë duhet të paraqitet ndonjë provë tjetër sepse provat që i  
15 kemi momentalisht të disponueshme tregojnë se një përfundim i  
16 tillë do të ishte i paarsyeshëm.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në përgjigje të  
18 parashtrimit tuaj, ju tani e dëgjuat nga palët se ata kanë  
19 ndërmend të paraqesin prova në lidhje me çdo fakt që keni  
20 paraqitur në dosjen tuaj dhe kjo do të thotë se barra e provës  
21 ju takon ju.

22 Pra, sot në mëngjes, u njoftuat nga Mbrojtja se ata do të  
23 paraqesin prova dhe se ju duhet t'i keni parasysh këto  
24 pretendime të Mbrojtjes.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju faleminderit. A ka edhe

1 ndonjë parashtrim tjetër?

2 Tema tjetër në radhë ka të bëjë me mbajtjen e materialeve  
3 dhe pretendimet e paraqitura nga Mbrojtja e Gucatit në lidhje  
4 me këto.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të jem i shkurtër.

6 Në urdhrin e 21 korrikut, Trupi Gjykues vuri në dukje  
7 parashtrimin e Mbrojtjes së Gucatit se: "Zyrtarë të ZPS-së  
8 paraprakisht kishin informuar njerëzit e OVL-UÇK-së se  
9 materialin mund ta mbanin deri në një muaj".

10 Në të njëjtin urdher, Trupi Gjykues thekson se do të  
11 ftojë ZPS-në të shprehet nëse kundërshton këtë pretendim të  
12 Mbrojtjes.

13 Përpara se t'ju japim fjalën, z. Halling, dua të theksoj  
14 se të dy ekipet e Mbrojtjes kanë identifikuar dëshmitarin tek  
15 numri 2 në listën e tyre, i cili ndër të tjera do të thirret  
16 për të dhënë dëshmi në lidhje me atë se çfarë i kanë thënë  
17 zyrtarët e ZPS-së, përkatësisht se "njerëzit e OVL -- se  
18 materialin mund ta mbanin deri në një muaj".

19 Z. Halling.

20 Z. HALLING: [Përkthim] ZPS-ja kundërshton fuqimisht këtë  
21 pretendim të Mbrojtjes sepse kjo në thelb kundërshton të  
22 gjitha provat e ZPS-së. Nuk ka asgjë në provat apo në shënimet  
23 zyrtare të asaj kohe që do të vinte në dukje se një gjë e  
24 tillë ishte diskutuar me atë person, sikurse pretendon z.  
25 Gucati.

1 Mbrojtja nuk ka paraqitur hollësi konkrete lidhur me këtë  
2 pretendim të vetin. Ata, Mbrojtja pra, përmendin vetëm paketën  
3 1 të dokumenteve. Një zyrtar i ZPS-së, që ka kryesuar  
4 operacionin, ka nënshkruar këtë shënim zyrtar ku konfirmon se  
5 ai nuk ka thënë asnjëherë një gjë të tillë sikurse pretendon  
6 Mbrojtja e Guccatit dhe për hir të nxjerrjes së materialit, ne  
7 do të nxjerrim këtë shënim zyrtar në lidhje me këtë deklaratë  
8 të punonjësit të sigurisë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, pyetja këtu  
10 është në lidhje me atë që tha Mbrojtja, se do të thërrasin  
11 persona për të dhënë dëshmi për vërtetimin e këtij pretendimi.  
12 Pra, unë thjesht ju pyes, nëse Prokuroria gjithashtu do të  
13 paraqesë dëshmi në lidhje me këtë apo do të paraqesë vetëm  
14 parashtrime gojore.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Parashtrimi jonë është se kjo  
16 është një shpifje dhe se për momentin, ne nuk kemi ndërmend që  
17 të paraqesim prova në lidhje me këtë pretendim të Mbrojtjes.

18 Në qoftë se informacionet e ardhshme kërkojnë që ne ta  
19 ndryshojmë këtë mendim, atëherë, do të kërkojmë leje nga Trupi  
20 Gjykes për të bërë ndryshimet e duhura. Mirëpo, për momentin  
21 nuk ka asgjë në prova që do të sugjeronte se ne duhet të  
22 ndërmarrim hapa të mëtejshme në lidhje me këtë pretendim të  
23 Mbrojtjes.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ka diçka Mbrojtja për të  
25 shtuar?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 13

1           Z. REES: [Përkthim] Po edhe njëherë i takon Prokurorisë  
2   që të provojë çështjen, thjesht Trupi Gjykses nuk do të  
3   kërkojë vetëm -- nuk do t'i zërë besë fjalës së Prokurorit  
4   sepse në gjykimet që kam marrë pjesë unë, nuk funksionon  
5   ashtu.

6           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Cadman keni diçka ju  
7   për të thënë?

8           Z. CADMAN: [Përkthim] Mbështes qëndrimin e kolegut tim z.  
9   Rees. Ne i kemi kërkuar ZPS-së shumë herë që të na japë  
10   deklaratat që ka marrë nga zyrtarët që kanë qenë të pranishëm  
11   gjatë operacionit 1, 2 dhe 3 dhe asnjë prej këtyre zyrtarëve  
12   nuk është përfshirë në listën e personave që do të japin  
13   dëshmi në gjykim. Neve na është mohuar mundësia që t'i  
14   shikojmë këto deklaratat e tyre dhe nuk na është dhënë asnjë  
15   farë hollësie në lidhje me to.

16          GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

17          GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani, i ftoj palët që të më  
18   bëjnë të ditur në qoftë se kanë ndërmend të bëjnë paraqesin  
19   mocione në bazë të rregullës 117(2) krahas atyre që tashmë  
20   Trupi Gjykses i ka marrë në përputhje me urdhrin 21 korrikut.  
21   Nëse po, palët duhet të bëjnë të ditur temën që do të  
22   trajtojnë mocione të tilla dhe nëse janë në gjendje të  
23   paraqesin këto mocione deri më 17 shtator dhe të dorëzojnë  
24   përgjigjet përkatëse, nëse do të ketë, deri më 24 shtator.

25          Kjo do t'i mundësojë Trupit Gjykses kohë të mjaftueshme

1 për të marrë vendimet në lidhje me to.

2 Z. Halling.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk kemi mocione të tjera për  
4 parashtruar dhe nuk kundërshtojmë orarin, afatin e dorëzimit  
5 të nocioneve të tilla.

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees. Urdhëroni.

7 Z. REES: [Përkthim] Për mendimin tonë, ka dy kategori që  
8 ende s'janë përmbyllur, qëndrojnë të hapura. E para është  
9 përcaktimi i statusit të pranueshmërisë së materialit të  
10 identifikuar në dosjen paraprake të Mbrojtjes. Aty kemi  
11 paraqitur listën e kundërshtimeve në lidhje me pranueshmërinë  
12 e materialit dhe kjo lidhet me materialet e përfshira në  
13 mocionin e Prokurorisë për paraqitjen e provave drejtpërdrejtë  
14 Trupit Gjykses, jo përmes dëshmitarëve.

15 Siç thashë edhe dje, këto materiale do të ndikojnë, këto  
16 vendime do të ndikojnë ndjeshëm në formën që do të marrë  
17 fillimi i gjykimit.

18 Çështja tjetër është nxjerrja e materialeve. Në këtë  
19 moment unë nuk jam në gjendje t'ju japë një farë parashikimi  
20 të hollësishëm sesi qëndrojnë punët, jemi të vetëdijshëm për  
21 urdhrin e Trupit Gjykses që dhatë dje, në lidhje me materialet  
22 sipas rregullës 102(3). Duhet të bëhet një kërkesë për  
23 redaktime nga ZPS-ja. Dhe sot përpara se të fillonte seanca,  
24 kolegët nga Prokuroria na thanë gojarisht, se ZPS-ja do të  
25 bëjë edhe një kërkesë për një seancë *ex-parte* ku do të ngrenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 çështjen e materialeve sipas rregullës 106 dhe rregullës 108.

2 Kemi qenë dje në ndërtesë deri në orën 19:00, kemi  
3 adresat elektronike, kemi mënyra të tjera të kontaktit dhe  
4 vetëm sot në mëngjes marrim një informacion të tillë.

5 Ju dje pasdite kërkuat që t'ju japim një njoftim paraprak  
6 në lidhje me natyrën e kundërshtimeve tona që kanë të bëjnë me  
7 nxjerrjen e materialeve.

8 Unë për momentin nuk kam parë ndonjë progres lidhur me  
9 këtë çështje. Thjesht shpresoj se do të arrijmë të përmbushim  
10 pritshmëritë e Trupit Gjykses dhe, se këta do të mund ta  
11 kryejmë deri në datën 17 shtator.

12 [Anëtarët e Trupit Gjykses konsultohen midis tyre]

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Besoj që nuk është habi, i nderuar  
14 Gjykatës, që edhe pozicioni jonë është i ngjashëm me  
15 pozicionin e z. Gucati. Ju lutem, më lejoni të them që kam të  
16 njëjtën përshtypje dhe ndaj gjithashtu edhe zemërimin e z.  
17 Rees lidhur me njoftimin e fundit.

18 Kemi ngritur edhe në të shkuarën që sa herë që ka  
19 nxjerrje Prokurorie neve shohim që mbas seancave, domethënë,  
20 marrim në momentin e fundit nxjerrjen e materialeve të cilat  
21 janë të rëndësishme për çështjen. Ndonjëherë mund t'i marrim  
22 shumë pak ditë përpara seancave me gojë.

23 Ne do të bëjmë kërkesa shtesë për sa i takon nxjerrjes  
24 dhe do të respektojmë afatet kohore të cilat janë të  
25 përcaktuara nga Trupi Gjykses. Megjithatë, kjo në vetvete

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 varet nga përgjigja që do të marrim nga Prokuroria dhe nga  
2 njoftimi në kohën e duhur prej tyre.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ndonjë përgjigje nga  
4 Prokuroria?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Shumë shkurtimisht.

6 Pra, sa i takon njoftimit për seancën sot, neve e kemi  
7 njoftuar pozicionin tonë që në mëngjes sot. Nuk është se e  
8 kishim këtë pozicion gati që në orën 07:00 të mbrëmjes një  
9 natë më parë. Nuk është se kemi pasur shumë kohë përpara  
10 seancës për shkak të ngarkesave të tjera.

11 Por, kur ngrihen çështje të tjera dhe në qoftë se  
12 mbrojtja ka nevojë për më tepër kohë që të përgjigjet në  
13 mënyrë të kuptimtë, ne nuk është se kemi ndonjë kundërshtim  
14 lidhur me këtë. Megjithatë, siç e thamë edhe njëherë, ne i  
15 kemi dhënë argumentet kryesore që synojmë që të përdorim edhe  
16 ne do të respektojmë edhe udhëzimet e dhëna nga ju, Trupi  
17 Gjykues.

18 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju keni bërë njoftim të plotë  
19 të natyrës së kundërshtimeve që unë kam urdhëruar dje.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

21 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk është kështu absolutisht  
23 jo.

24 Z. REES: [Përkthim] E gjithë gjëja që ne kemi janë  
25 referencat e dy rregullave që propozohen që të përdoret prej



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 Prokurorisë. Pra, kjo nuk është në pajtim me atë çfarë ju i  
2 keni thënë dje, i nderuar, z. Halling.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] A keni pasur njoftim me  
4 shkrim për këtë gjë?

5 Z. REES: [Përkthim] Jo, jo nuk kemi pasur fare njoftim me  
6 shkrim. Në fakt, vetëm disa sekonda përpara sesa të fillonte  
7 seanca, neve na u tregua, na u tha nga Prokuroria, që do të  
8 mbështeten në rregullën 106 dhe 108.

9 Dje, sigurisht, z. Halling tha që natyra e  
10 kundërshtimeve, domethënë, nuk është se ishte një kundërshtim  
11 në vetvete, por bëhej fjalë për një kërkesë për masa  
12 mbrojtëse. Kështu që, unë të gjithë mbrëmjen mbrëmë dhe sot në  
13 mëngjes e kam shpenzuar duke parë dispozitat përkatëse për  
14 masat mbrojtëse.

15 Pra, ne jemi munduar që të angazhohemi me ZPS-në mbi bazë  
16 ex-parte përpara se të fillonte kjo seancë të martën dhe  
17 shkova për të biseduar me kolegët e mi në zyrën e ZPS-së për  
18 këtë çështje, domethënë, për rregullën 102(3) dhe mua mu dha  
19 përgjigja që: Gjykata e Apelit ka dhënë një vendim, nuk është  
20 se e kanë urdhëruar atë, kështu që, nuk kemi pse shikojmë  
21 asgjë tjetër.

22 Kështu që, me fjalë të tjera, do të doja të thosha që  
23 neve nuk është se jemi njoftuar dhe kjo është në kundërshtim  
24 me atë që kemi urdhëruar juve dje.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kjo nuk është e mjaftueshme.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 18

1 Zyra juaj, brenda një ore, duhet t'i japë Mbrojtjes deklaratën  
2 e plotë me shkrim lidhur me natyrën e kundërshtimeve tuaja dhe  
3 jo vetëm thjesht referencën dhe citimin lidhur me numrin e  
4 rregullave.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e kuptojmë, i nderuar.

6 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] E gjithë kjo ka të bëjë me  
7 nxjerrjen e materialeve dhe nxjerrja është një pjesë e  
8 domosdoshme e këtyre proceseve. Kështu që, është shumë e  
9 rëndësishme për të qenë transparent dhe për të dhënë  
10 informacionin e duhur.

11 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptojmë.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Tani kalojmë tek pjesa e  
13 fundit e agjendës dhe e kam fjalën posaçërisht për prezantimin  
14 ose paraqitjen e lëndëve nga të dyja palëve. Ndërkohë, sipas  
15 urdhrin të 21 korrikut, unë i kam kërkuar ZPS-së që të thotë  
16 në qoftë se vlerësimi i vetë lidhur me kohën e nevojshme për  
17 prezantimin e paraqitjen e çështjes së saj ka ndryshuar  
18 veçanërisht duke marrë parasysh dëshmitarët e propozuar shtesë  
19 edhe në qoftë se Mbrojtja pritet që të jetë e pranishme në  
20 emër të ZPS-së gjatë proceseve gjyqësore.

21 Z. Halling.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk është se kemi ndryshime sa i  
23 takon listës së dëshmitarëve. Sigurisht, që ne duhet që të  
24 rishikojmë vlerësimet për një dëshmitar të tretë në qoftë se  
25 autorizohemi për ta bërë këtë gjë.

1 Ndërkohë sa i takon paraqitjes së provave prej nesh,  
2 grupi jonë është i tillë, pra, do të jem unë, do të jetë  
3 Valeria Bolici, Line Pederson dhe staf tjetër nga ZPS-ja.  
4 Ndërkohë personat e tjerë të cilët mund të jenë të pranishëm  
5 gjatë parashtrimeve janë edhe personat në udhëheqje të ZPS-së,  
6 siç është p.sh., zëvendësprokurori i ZPS-së.

7 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të doja  
8 që t'i kthehesha Mbrojtjes të shprehet lidhur me këtë çështje  
9 edhe, në qoftë se do të dëshironi që të jepni një deklaratë  
10 hyrëse pas deklaratës hapëse të ZPS-së apo, në qoftë se  
11 dëshironi njëherë që të dëgjoni parashtrimin e çështjes nga  
12 Prokuroria dhe pastaj të bëni deklaratat hapëse tuaja.

13 Pra, e kuptoj që një pjesë e mirë kësaj mund të varet nga  
14 mënyra ose nga koha se kur përfundon paraqitja e çështjes nga  
15 Prokuroria edhe po ashtu, do të doja që të më thoni në qoftë  
16 se keni një vlerësim sa i takon kohës që keni nevojë për  
17 paraqitjen e çështjes tuaj dhe sa kohë ju duhet gjithashtu  
18 edhe për përgatitjen pas mbylljes së paraqitjes së çështjes  
19 nga Prokuroria.

20 z. Rees, fjala për ju.

21 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

22 Për shkak të progresit të çështjes së Prokurorisë, e cila  
23 është e pazakontë, më duhet të them që nuk është detyrë e  
24 thjesht për neve për të dhënë një vlerësim të përgjithshëm të  
25 kohës që na nevojitet. Unë kam përgatitur atë çfarë mendoj që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 20

1 është një, le të themi, një vlerësim realist i rastit më të  
2 keq ose skenarit më të keq, megjithatë, në realitet mbase  
3 gjykimi mund të jetë më i shpejtë sesa kaq.

4 Po ashtu, unë jam koordinuar dhe me z. Cadman, sepse ne  
5 jemi të vetëdijshëm për faktin që ka mbivendosje ndërmjet  
6 listave të dëshmitarëve dhe jemi të vetëdijshëm, po ashtu,  
7 edhe lidhur me parashtrimet sa i takon kësaj pjese të çështjes  
8 tonë. Kështu që, unë do thoja që vlerësimi për paraqitjen e  
9 provave nga Mbrojtja është i përafërt.

10 Sa i takon dëshmitarit 1, do ta quaj dëshmitari 1, pra,  
11 nuk do ta quaj me pseudonim, po thjesht do them për momentin  
12 dëshmitarja 1, të cilës, pra, i është dhënë një program që ka  
13 397 rreshta të gjatë. Pra, kemi një total prej 917 faqesh. Dhe  
14 do të duhet të shohim në qoftë se provat janë të pranueshme  
15 për këtë çështje. Pra, do të mundohem që të them dhe do të  
16 doja të thosha që unë do të mundohem që pyetjet të jenë sa më  
17 konciz të jetë e mundur, megjithatë, nuk është se kam parë  
18 asnjë material që dëshmitari do të prezantojë si pjesë e  
19 raportit analitik dhe mbase mund të na duhen deri në shtatë  
20 ditë sa i takon kundërpjetjeve. E kam fjalën këtu për  
21 materialin që është mbledhur si rezultat i kërkimit të  
22 organizuar më 25 shtator.

23 Lidhur me dëshmitarin 2, i cili ka prodhuar një raport  
24 mbështetur në 107 shënime zyrtare të kontakteve me  
25 dëshmitarët. Dhe dëshmitari 2 është përfshirë në 15 nga këto

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 107 shënime personalisht. Dhe sërish, në qoftë se një provë e  
2 tillë nuk është e pranueshme me nxjerrjen e kufizuar dhe duke  
3 vlerësuar gjithashtu faktin që kemi të bëjmë me një dëshmitar,  
4 i cili po jep prova të dorës së tretë, jo të dorë së dytë, të  
5 cilat të gjitha mund të jenë të debatueshme, të diskutueshme  
6 dhe ku çështja e saktësisë, besueshmërisë, vërtetësisë dhe e  
7 kredibilitetit të personave të përfshirë, mendoj që do të më  
8 duhet rreth pesë ditë për t'u marrë me dëshmitarin numër 2.  
9 Pra, sërish do të doja të thoja, që deklarata dhe provat  
10 materiale të këtij dëshmitari janë qindra faqe, mbi njëqind  
11 faqe.

12 Unë nuk propozoj që të bëjë një deklaratë hapëse pas  
13 deklaratës hapëse të ZPS-së.

14 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk do të bëni?

15 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk mendoj që do të bëj një  
16 deklaratë hapëse. Aktualisht do të shqyrtoj mundësinë e hapjes  
17 pasi ZPS-ja të ketë paraqitur çështjen e saj. Pra, pasi të  
18 jenë thirrur të gjithë dëshmitarët e Mbrojtjes edhe të  
19 pandehurit, mendoj që gjithë-gjithë do të duhen rreth tre  
20 javë.

21 Ndërsa i takon kohës për përgatitjen e Mbrojtjes, pasi  
22 prokuroria të ketë parashtruar çështjen e saj, koha e cila  
23 parashikohet në parashtrimet e Zyrës së Administrimit në  
24 urdhrin për realizimin e procedurave, pra, ky Udhëzim i Punës  
25 mua më duket sikur është hartuar duke pasur parasysh një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 natyrë të ndryshme dhe me fjalë të tjera, domethënë, ne nuk  
2 është se parashikojmë një kohë e cila është e ndryshme nga  
3 Udhëzimi i Punës me të cilin punon Zyra e Administrimit.  
4 Mendoj që një javë do të ishte e mjaftueshme sa i takon pjesës  
5 së përgatitjes.

6 Kjo na çon në një pozicion të një vlerësimi të  
7 përgjithshëm mesatar, përfshirë këtu, edhe atë çfarë është një  
8 kohë e arsyeshme për deklaratën hapëse të Prokurorisë dhe  
9 sigurish edhe me parashtrimin e pozicionit.

10 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për  
11 ndërprerjen.

12 Z. REES: [Përkthim] Prokuroria, pra, tha që do të shfaqet  
13 videoja dhe ne llogarisim që do të kemi, mesatarisht, tre ditë  
14 videoregjistrim. Dhe së bashku me vlerësimet të cilat janë  
15 dhënë sa i takon kohës për pyetjes kryesisht të dëshmitarit 1  
16 dhe 2 në dosjen paraprake të Prokurorisë dhe duke lejuar,  
17 gjithashtu edhe ca kohë, megjithëse, nuk është se e dimë tamam  
18 sa kohë do të duhet për dëshmitarin e tretë, sepse nuk e dimë  
19 përmbajtjen e deklaratës së këtij dëshmitari neve parashikojmë  
20 thuajse nëntë deri dhjetë javë gjithsej për këtë pjesë.

21 Sa i takon Mbrojtjes, sa i takon trupit tonë, unë synoj  
22 që të jem i pranishëm gjatë gjithë procesit gjyqësor, z.  
23 Bowden do të jetë së bashku me mua.

24 Unë, angazhimet e mia në çështjet e tjera, në fakt, i kam  
25 kufizuar sa më shumë të jetë e mundur gjatë kësaj periudhe

1 kohore. Megjithatë, kam disa angazhime të cilat nuk mund t'i  
2 anashkaloj. Megjithatë ato janë të shkurtra në kohëzgjatje,  
3 kështu që, do t'i kërkoj Trupit Gjykues në kohën e  
4 përshtatshme që të ketë paksa më shumë fleksibilitet apo  
5 ndihmë për mua në mënyrë që të mund të përmbush detyrimet e  
6 tjera, të cilat i kam marrë përsipër shumë kohë më përpara.  
7 Pra, bëhet fjalë vetëm thjeshtë për pesë ose gjashtë ditë.

8 Megjithatë gjatë atyre ditëve z. Bowden do të jetë këtu  
9 gjatë gjithë kohës dhe siç thashë, domethënë, do të kërkoj  
10 gjithashtu edhe ca fleksibilitet nga ZPS-ja lidhur me mënyrën  
11 e planifikimit të punës që do të na presë ose që do të  
12 realizohet gjatë atyre ditëve, që mbase nuk jam i pranishëm.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po, ju jeni, besoj, i  
14 ndërgjegjshëm për faktin që ka dhe një proces tjetër gjyqësor  
15 që do të fillojë në të njëjtën sallë gjyqi dhe do të duhet që  
16 të ndajmë të njëjtën sallë. Kështu që, në qoftë se ju thoni  
17 tre javë, e keni fjalën p.sh., tre javë me nga pesë ditë pune,  
18 domethënë 15 ditë apo e keni fjalën për ndonjë konfigurim  
19 tjetër?

20 Z. REES: [Përkthim] Sigurisht, domethënë ne kemi bërë ca  
21 spekulime ndërmjet vetes sesi me një sallë të vetme gjyqi  
22 gjërat do të zhvillohen më tej. Ne, ndërkohë e dimë, që kemi  
23 një proces tjetër gjyqësor që do të fillojë së shpejti.

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mund t'ju them dhe mbase kjo  
25 mund t'i ndihmojë dhe të tjerët, pra, neve, domethënë, ideja

1 është që ne nuk është se mund të punojmë çdo ditë në sallën e  
2 gjyqit sepse kemi përkthyesit dhe kemi, gjithashtu, edhe  
3 procese të tjera gjyqësore të cilat do të duhet që të përdorin  
4 të njëjtën sallë. Mbase, do të kemi dy ditë në javë dhe neve,  
5 gjithashtu, na janë ofruar dy javë të plota pa ndërprerje në  
6 fund të tetorit, çfarë do të thotë që mund të kemi tetë ditë  
7 të plota seance gjyqësore gjatë kësaj periudhe.

8 Domethënë, thjeshtë sa për t'ju thënë pak më shumë  
9 informacion. Pra, kjo është mënyra sesi do ta përgatisim  
10 seancën dhe sesi do të përdorim hapësirën që na duhet ta  
11 bashkëndajmë edhe me koleg të tjerë.

12 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit për informacionin që na  
13 dhatë, ishte shumë i dobishëm.

14 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Duhet të kemi parasysh dy  
15 gjëra. Gjëja e parë është që kemi dy javë të pandërprera në  
16 dispozicion në fund të tetorit dhe së dyti, elementi tjetër  
17 është që klientët tuaj janë në paraburgim dhe ne duam që kjo  
18 çështje të zhvillohet, të gjykohet në mënyrë të përsheptuar.  
19 Besoj që të gjithë e kuptojnë këtë gjë dhe besoj që të gjithë  
20 e presin këtë gjë.

21 Z. REES: [Përkthim] Absolutisht po. Pra, palët si  
22 Prokuroria dhe Mbrojtja e kanë diskutuar këtë çështje dhe të  
23 gjithë jemi në një mendje dhe jo vetëm kryesisht për faktin  
24 që, siç e thatë juve i nderuar Gjykatës, z. Haradinaj dhe z.  
25 Gucati thuajse se janë 12 muaj në paraburgim tani dhe ne kemi



1 biseduar dhe shpresojmë që, le të themi, kjo çështje të  
2 përfundoj brenda këtij viti kalendarik.

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. REES: [Përkthim] Periudhat që ju kemi dhënë synohen që  
5 të përfshihen. Ne nuk është se kemi parashikuar p.sh., që të  
6 qëndrojmë apo të kemi seanca gjyqësore çdo ditë.

7 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kur thoni tre javë, e keni  
8 fjalën për 15 seancash gjyqësore?

9 Z. REES: [Përkthim] Jo, e kemi fjalën për blloqe më shumë  
10 sesa për ditë specifike njëra pas tjetrës.

11 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Cadman, e njëjta pyetje. Në qoftë se keni të përgjigje  
13 nuk është e thënë që duhet t'i përsërisni gjërat që tha z.  
14 Rees.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar, më lejoni të them, që  
16 unë dhe z. Rees jemi konsultuar edhe pozicioni ynë do të varet  
17 shumë nga prezantimi i lëndës nga Prokuroria. Kështu që,  
18 afatet kohore janë pak shumë të njëjtat.

19 E sa i takon përfaqësimit të klientit që unë përfaqësoj,  
20 ne nuk është se parashikojmë ndonjë ndryshim të trupit apo të  
21 personave që janë të pranishëm në sallën e gjyqit sot. Dhe ne  
22 jemi të interesuar, z. Haradinaj është shumë i interesuar që  
23 kjo çështje të zgjidhet përpara fundit të këtij viti po ashtu.

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë sa më shumë të  
25 jetë e mundur, më të mirën tonë të mundshme, që të këshillojmë

1 të gjithë ata të cilët merren me planifikimin në mënyrë që  
2 juve të zini datat. Ne nuk është se mund t'ju themi me qartësi  
3 sot se cilat janë këto data, por ndoshta në ditët në vijim.

4 Dhe keni parasysh që, unë po negocioj me Trupin tjetër  
5 Gjykues gjatë gjithë kohës dhe kjo është mënyra sesi ne  
6 siguroam dy javët në fund të tetorit. Domethënë paneli tjetër,  
7 Trupi tjetër Gjykues nuk do të përdorte sallën e gjyqit në dy  
8 javët e fundit të tetorit, kështu që, neve vendosëm që do ta  
9 përdorim gjatë gjithë kohës sallën gjatë kësaj periudhe.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] E vetmja gjë që kam për të shtuar  
11 është që edhe në qoftes se kemi, le të themi, ideja ishte që  
12 të fillonim me procesin ndoshta nga nëntori por edhe, në qoftë  
13 se kemi një tërheqje më përpara kësaj periudhe kohore, prapë  
14 nuk është problem për ne.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Unë do të jap një urdher me  
16 shkrim sot pasdite sa i takon disa prej këtyre çështjeve.

17 Në urdhrin e 21 korrikut, neve treguam apo dhamë një datë  
18 provizore sa i takon konferencës së përgatitjes nga ZPS-ja për  
19 të mërkurën dhe të enjten, më datën 8 dhe 9. Do të doja të  
20 pyesja prokurorinë në qoftë se këto data janë në rregull për  
21 juve apo jo?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, janë në rregull.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees?

24 Z. REES: [Përkthim] Po. Në rregull dhe për neve.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Cadman?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 27

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, në rregull.

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit  
3 për bashkëpunimin.

4 Siç e thashë edhe më përpara, ne po mundohemi që të jemi  
5 sa më efektiv lidhur me kohën e disponueshme dhe me seancat.  
6 Dhe, siç kërkohet nga rregullat, nga rregullorja, ne duhet që  
7 të caktojmë një datë për çeljen e procesit dhe duhet që ta  
8 hapim këtë gjykim brenda 30 ditësh sipas rregullores. Unë do  
9 të doja t'ju them se ne parashikojmë që data e hapjes së  
10 gjykimit dhe data për dëgjimin e deklaratave hapëse të jetë me  
11 7 dhe 8 tetor edhe pastaj të vazhdojmë që të dëgjojmë provat  
12 materiale nga data 18 tetor dhe të vazhdojmë për dy javë të  
13 plota siç unë e përmenda dhe më parë.

14 Atëherë, nuk dua ta diskutoj sepse e di, domethënë, sepse  
15 duhet shumë planifikim prej jush, megjithatë, unë po mundohem  
16 që të them, t'ju jap aq informacion sa kam në mënyrë që juve  
17 t'i diskutoni ndërmjet jush dhe në mënyrë që të planifikoni  
18 për hapat pasardhës.

19 Z. Cadman doni të merrni fjalën?

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Dua të them diçka lidhur me  
21 deklaratën hapëse të Mbrojtjes. Pozicioni jonë është i njëjti.  
22 Ne nuk është se do japim një deklaratë hapëse nga ana jonë  
23 deri në momentin që të ketë përfunduar paraqitjen e çështjes  
24 Prokuroria.

25 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirë faleminderit, ju kërktoj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 28

1 ndjesë që nuk ju kërkova të më përgjigjeshit për këtë pyetje.

2 Atëherë, ju lutem, keni parasysh këto data që sapo i  
3 përmendëm dhe do të mundohemi t'i respektojmë ato sa më shumë  
4 të jetë e mundur.

5 Kemi arritur në fund të programit të planifikuar për sot.

6 Edhe diçka tjetër. Mbrojtja e z. Haradinaj kanë ngritur  
7 çështjen e përdorimit të kompjuterëve privatë nuk e di nëse  
8 është zgjidhur kjo gjë apo?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, e zgjidhëm këtë gjë.

10 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Faleminderit Zyrës së  
11 Administrimit që e lehtësuat dhe e zgjidhët këtë çështje.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk e di a ka ndonjë çështje  
13 tjetër që do të donit ngrinit për këtë seancë sot. Nga  
14 Prokuroria ka ndonjë gjë?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. nuk kemi.

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees? Atëherë kemi dhe një  
17 çështje tjetër të madhe që na pret që të shqyrtojmë por,  
18 gjithsesi, do e trajtojmë atë kur t'i vijë koha.

19 Z. Cadman për momentin keni ndonjë pyetje?

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, i nderuar për momentin nuk kam  
21 asnjë pyetje.

22 [Anëtarët e trupit gjykues këshillohen ndërmjet  
23 tyre]

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Për shkak të nevojës për të  
25 patur dokumentin e përditësuar nga ZPS-ja për t'ia dhënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 29

1 Mbrojtjes, ne do të bëjmë pushim deri në orën 11:00. Besoj që  
2 do jemi gati për të filluar në orën 11:00. Ju lutem, jepjani  
3 dokumentin Mbrojtjes përpara orës 11:00, në mënyrë që ata të  
4 mund t'i hedhin një sy përpara se ne të fillojmë. Domethënë  
5 deri në orën 11:00 do të bëjmë pushim.

6 Z. Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] I nderuar, shumë shkurtimisht.

8 Në këtë aspekt për këtë çështje, pra, në qoftë se ne e  
9 shohim dokumentin, në qoftë se do na kërkohet do na nevojitet  
10 më shumë kohë për ta shqyrtuar përmbajtjen e dokumentit të  
11 Prokurorisë, a mund të kontaktojmë me juve në mënyrë që të  
12 mund t'ju themi që kemi nevojë për më tepër kohë?

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po patjetër. Mund të  
14 kontaktoni me Vikin.

15 --- Pushimi fillon në orën 10.25

16 --- Rifillon në orën 11.00

17 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë. Kemi  
18 marrë një kopje të njoftimit, e kemi lexuar. Mbrojtja na ka  
19 bërë të ditur se ka nevojë për kohë shtesë. Do të fillojmë me  
20 deklaratën e Prokurorit tani, do bëjmë pushim, do të kthehemi  
21 të dëgjojmë dhe Mbrojtjen dhe pastaj do të vijojmë. Unë ju  
22 falënderoj të gjithëve paraprakisht për durimi.

23 Z. prokuror keni fjalën.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
25 Urdhri juaj kërkonte një diskutim mbi redaktimet në njoftimin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë private)

Faqe 30

1 e rregullës 102(3) lidhur me procesin përmes të cilin janë  
2 nxjerrë materialet OVL-UÇK-së.

3 Ju keni kërkuar për një diskutim *inter partes* por në  
4 kuptim të këtij diskutimi do të kërkonim që të kalonim në  
5 seancë private.

6 [Seancë private]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë  
8 private.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Argumentet tona mbështeten në  
10 njoftimin që sapo keni lexuar ju. Ju kërkojmë ndjesë Gjykatës  
11 dhe Mbrojtjes për vonesën. Nuk kemi ndërmend që të fshehim  
12 qëndrimin tonë lidhur me këtë dhe në të ardhmen do t'i mbajmë  
13 parasysh edhe fjalët tuaja.

14 Ne kemi një hetim që është duke vijuar sa i takon  
15 dorëzimit të paketave është delikat edhe i pambyllur. Mendojmë  
16 se është tejet cënues për këtë hetim nëse do të nxirrnim çdo  
17 gjë sesi janë bërë këto dorëzimet e këtyre materialeve, sepse  
18 mes të tjerash, krijon mundësi për nxjerrje të tjera të  
19 paligjshme.

20 Renditja e këtyre materialeve me hollësi, sikurse  
21 përcaktohet në rregullën 102(3), patjetër që do të zbulonte  
22 pistat e hetimit sesi ka ndodhur kjo. Nëse listimi i  
23 materialeve kërkon kufizime mbi nxjerrjen që ekzistojnë në  
24 këto rregulla, siç është rregulli 106 dhe rregulli 108,  
25 atëherë ne parashtrojmë se Trupi Gjykses mund të urdhëroj

1 mosnxjerrjen e kësaj pjesë të njoftimit të rregullit 102(3).

2 Rregulla 108(1) lejon mosnxjerrjen e informacioneve sipas  
3 rregullit 102, jo thjesht rregullin 102(1), pra, të gjithë  
4 këtë rregull, kur nuk duam që të cenojmë hetime të tanishme  
5 dhe të ardhshme. Nxjerrja e këtyre informacioneve do të  
6 paraqiste rreziqe për sigurinë e dëshmitarëve.

7 Ky rregull i jep të drejtë ZPS-së që të bëjë parashtrime  
8 *ex-parte* lidhur me mosnxjerrjen e këtij informacioni.

9 Krahas kësaj një pjesë të këtyre materialeve janë  
10 produkte të brendshme të punës sipas rregullit 106. Rregulli  
11 106 shprehimisht parashikon se raportet, aktet e brendshme dhe  
12 dokumentet të tjera të brendshme të përgatitura nga një palë  
13 apo nga avokati i viktimave, asistentët dhe përfaqësuesit e  
14 tyre në lidhje me hetimet apo përgatitjen e çështjes nuk janë  
15 objekt i nxjerrjes apo njoftimit sipas këtyre rregullave.

16 Ne nuk kemi asnjë detyrim që të njoftojmë informacione të  
17 tilla, materiale të tilla. Ne kërkojmë lejen që të bëjmë  
18 parashtrime eksporte, për t'i dhënë Trupit Gjykses hollësi të  
19 tjera sa i takon elementeve dhe rreziqeve nëse do të jepnin  
20 njoftim për të përshkruar hetimin tonë në këtë çështje. Me  
21 fjalë të tjera, jemi të përgatitur që t'u japim një përshkrim  
22 kuptimplotë gjykatësve se çfarë do të ishte në njoftimin e  
23 përditësuar të rregullit 102(3) që ne po mendojmë. Jemi të  
24 gatshëm që këtë ta bëjmë ose gojarisht ose me shkrim. Nëse  
25 Trupi Gjykses dëshiron që kjo të bëhet gojarisht, z. Whiting

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë private)

Faqe 32

1 është i gatshëm që t'i drejtohet Trupit Gjykses për këtë sot  
2 në një seancë *ex-parte* me të gjitha hollësitë e mëtejshme.  
3 Faleminderit.

4 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kam një pyetje.

5 Për këtë vendim, pra, për vendimin e panelit të Gjykatës  
6 së Apelit jeni në dijeni që prej datës 29 korrik. Ky vendim  
7 thotë qartë se materiali përkatës duhet të përfshihen në  
8 listën e rregullit 102(3). Pse e kërkoni sot këtë lloj  
9 redaktimi apo vendim për këtë? Pse prisni deri në konferencën  
10 përgatitore për gjykimin? Unë mendoj se ishte shumë e qartë që  
11 duhet ta kishit përpara, të paktën, siç e lexoj unë atë  
12 vendim.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Përgjigja vjen nga pjesa e  
14 vendimit, e dispozitivit të vendimit që ju përmendët.

15 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka nxjerrë dy vendime  
16 procedurale në vendimin e kontestuar që në apelim. Një për  
17 njoftimin e rregullit 102(3) dhe një të dytë për nxjerrjen.  
18 Nëse paneli i apelit do ta kishte shuar vendimin apo do ta  
19 kishte rikthyer për gjykim, atëherë ne do ishim përgatitur.  
20 Paneli i apelit nuk e bëri këtë gjë. Ato e konfirmuan vendimin  
21 procedural në tërësi.

22 Njoftimi i rregullit 102(3) e ka për qëllim që të kemi  
23 diskutim të fokusuar sa i takon materialitetit të  
24 informacionit në fjalë. Kur Paneli i Apelit e konfirmoi,  
25 konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nuk kishte



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë private)

Faqe 33

1 materialitet *prima facie* të treguar nga Mbrojtja, nuk kishte  
2 kuptim që të listonim këto materiale. Nuk do të kishte kuptim  
3 se do të kishim bërë një rrotullim vendnumëro, do të ishim në  
4 të njëjtin vend si më përpara.

5 Vendimi i apelit nuk kërkonte prej nesh ndonjë veprim  
6 tjetër sepse nuk gjeti ndonjë gabim.

7 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ky është një veprim  
8 interesant nga ana juaj. Ka pyetje?

9 Gjykatësi Mettraux, keni fjalë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, gjykatësi  
11 Smith.

12 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim të kthehemi në  
13 seancë publike?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Pa e ditur se çfarë pyetjesh të  
15 tjera do bëhen, e kam të vështirë, por jua lë juve në dorë.

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Rikthehemi në seancë publike.

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi rikthyer në seancë  
19 publike.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Kolegë, pyetjen.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Halling duhet që t'i rikthehem çështjes së  
23 materialitetit, shkurtimisht. Nëse e marrim si të mirëqenë  
24 nëse interpretimi juaj që i bëni vendimit të apelit është i  
25 saktë, a nuk është e saktë se paaftësia e Mbrojtjes për të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 34

1 demonstruar materialitetin është e lidhur ngushtë me mungesën  
2 e një liste materialesh, të cilat Mbrojtja mund t'i  
3 shqyrtonte, të paktën për t'i kuptuar në përgjithësi, se  
4 vërtet ka diçka që ju keni në zotërim e cila mund të ishte me  
5 rëndësi materiale për Mbrojtjen. Nëse ato nuk e kanë një  
6 instrument të tillë në dorë si do të sugjeronit ju se do ta  
7 dëshmonin materialitetin ekipet e Mbrojtjes?

8 Dhe kam edhe një gjë të dytë për të thënë, ju kërkoj  
9 parashtrime për këtë, Materiali për të cilin ne po flasim  
10 tani, në mënyrë shumë abstrakte do të thosha për fat të keq,  
11 ky material, a përmban prova të mundshme për ndonjë prej  
12 fakteve materiale të cilat Mbrojtja i propozon si të  
13 rëndësishme për anën e tyre. Ju si ZPS jeni të vetmit që e  
14 keni parë këtë material, e njihni këtë material, rregullorja e  
15 njeh parimin e nxjerrjes me përjashtime, në lidhje me të  
16 cilat, ju mbartni barrën.

17 Pra, kam dy pyetje: së pari, a e pranoni se pamundësia e  
18 Mbrojtjes për ta përmbushur kriterin *prima facie* sa i takon  
19 materialitetit është e lidhur ngushtë me mosdhënien nga ana  
20 juaj e një liste Mbrojtjes, së pari; dhe, së dyti, a po flasim  
21 për një material, që në bazë të asaj që ju dini nga dosjet  
22 paraprake të Mbrojtjet, mund të ishin me rëndësi për  
23 konstatimin e fakteve nga ana e tyre? Do të doja që t'u  
24 përgjigjeshit në publik këtyre pyetjeve, për aq sa mundeni.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Një përgjigje e shkurtër për pyetjen e parë, jo gjithmonë  
2 dhe jo në këtë rast. Për pyetjen e dytë jo. Por unë do t'i  
3 shpjegoj të dyja përgjigjet.

4 Sa i takon lidhjes midis njoftimit të rregullit 102(3)  
5 dhe materialitetit është e qartë nga vendimi i apelit se nuk e  
6 kanë konsideruar të rëndësishëm në këtë rast. Domethënë, nëse  
7 ka gabim në arsyen 1 që ndikon në arsyen 2, atëherë nuk do ta  
8 kishim konfirmuar këtë vendim. Do ta kishim kundërshtuar  
9 materialitetin. Gjykata e Apelit nuk e konsideronte të  
10 nevojshme këtë gjë, që do të thotë, se kjo lidhje e veçantë që  
11 keni identifikuar ju nuk është konstatuar nga paneli i apelit.

12 Ato u bazuan edhe nga mënyra sesi është sjellë Mbrojtja,  
13 sepse Mbrojtja sigurisht mund të kishin apeluar vetëm  
14 njoftimin e rregullit 102(3) dhe të kishin kundërshtuar  
15 materialitetin në një moment tjetër.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju ndërpres. Po edhe  
17 njëherë. Ta zëmë se interpretimi juaj është i saktë dhe çfarë  
18 mendoni se do të ndodhë? Mbrojtja do të bëjë një kërkesë për  
19 listën, që e ka bërë këtë kërkesë dhe pasi ta shqyrtojmë  
20 listën, atëherë, do të thonë se cilat janë dokumentet.

21 Pra, sigurisht, ata e kanë paraqitur kundërshtimin dhe  
22 ndodhemi në këtë problematikë tani, pavarësisht, nga hapi  
23 proaktiv që është ndërmarrë nga Paneli i Apelit dhe nëse e  
24 marrim sitë mirëqenë, se kjo është e nevojshme dhe, nëse janë  
25 të nevojshme që të merren masat e konfidencialitetit që ju

1 kërkonti.

2 Prandaj, unë i bashkohem komentit të gjykatësit Smith, që  
3 vonesa, që ne vëmë re në veprimet tuaja, pra, e nënvijëzoj  
4 këtë vonesë nga ana juaj.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne jemi të qëndrimit se kjo  
6 është zgjidhur në Procedurën Paraprake sepse nga ana  
7 strukturore qëllimi i të pasurit të një gjykatësi të  
8 Procedurës Paraprake është që të zgjidhë pikërisht këto  
9 çështje të cilat, pra, siç është zgjidhja përpara se t'ia  
10 kalojnë para Trupit Gjykses.

11 Ne e kuptojmë tani se Trupi Gjykses është i interesuar  
12 që ta rihapë këtë problem, sigurisht, Trupi Gjykses e ka këtë  
13 të drejtë, e kanë detyrim në fakt, që të sigurojnë zhvillimin  
14 e shpejtë të procesit.

15 Nuk është e nevojshme që të rihapet ky problem, kjo  
16 çështje, ky aspekt sepse këtë e them në bazë të vendimit të  
17 Apelit sepse, nëse Paneli i Apelit duhet ta kishte konsideruar  
18 të arsyeshëm, do ta kishte rikthyer për rimarrje vendimi tek  
19 Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

20 Sa i takon pyetjes së dytë, pra, sa i takon  
21 informacioneve që mund të ishin me rëndësi për Mbrojtjen në  
22 materialet tona, do të thosha "jo". Ne i kemi shqyrtuar  
23 materialet nga këndvështrimi i Mbrojtjes. Nuk ka asgjë aty.

24 Unë e kuptoj që ju keni vetëm fjalën time, nga mund ta  
25 dini juve kur nuk i keni parë këto materiale? Këtë e kuptojmë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 37

1 Prandaj edhe kërkojmë mundësinë që të bëjmë parashtrime ex-  
2 parte për t'ju dhënë më shumë informacione pas të cilave Trupi  
3 Gjykses do të jetë më i informuar. Prandaj edhe e përsërisim  
4 këtë kërkesë për ju, gjykatës duke shprehur se ky është  
5 qëndrimi ynë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit z. kryetar.

8 Z. Halling, desha t'ju bëj nja dy pyetje sa i takon  
9 qëndrimit të ZPS-së, sa i takon arsyeve për mosnxjerrje të  
10 raporteve, akteve dhe dokumenteve të tjera të brendshme të  
11 cilat i ka përgatitur Task-Forca e Specializuar Hetimore apo  
12 ZPS-ja në lidhje me punën e vet hetimore të cilat parashtrihen  
13 dhe në fjalinë e fundit të rregullit 106.

14 Ky privilegj kundër nxjerrjes që mbron ZPS-në dhe  
15 Mbrojtjen është për produktet e brendshme të punës. Dua të  
16 sqaroj çfarë është produkti i brendshëm i punës. Ky i produkt  
17 i brendshëm i punës, a është ndonjë material, pjesërisht, të  
18 cilin ju thoni se është nxjerrë në mënyrë të paligjshme në atë  
19 shkallë sa përbën një vepër penale si pjesë e thelbit të  
20 çështjes me të cilën kemi të bëjmë në këtë procedurë?

21 Dhe, së dyti, unë mund të imagjinoj se ka produkte të  
22 brendshme pune të cilat sipas parashtrimit tuaj nuk janë  
23 nxjerrë në mënyrë të paligjshme dhe kriminale. Për të cilat  
24 materiale e keni fjalën, për të cilët materiale nuk doni t'ia  
25 nxirrni Mbrojtjes në bazë të rregullit 106?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetjet tuaja janë të vështira që  
2 unë të përgjigjem në seancë publike, por do të përpiqem.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mund t'ju ndihmoj. Nëse ka  
4 informacion i cili ju thoni është objekt i rregullit 106, sa i  
5 takon mosnxjerrjes dhe është, po kështu, edhe informacion që  
6 ka dalë tashmë në publik si pasojë e atyre që ju pretendoni se  
7 janë aktivitete kriminale, a është kjo vërtet objekt i  
8 privilegjit që ofron rregulli 106 për produktet e brendshme të  
9 punës?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Kur ne përmendim rregullin 106 në  
11 këtë kuadër nuk e kam fjalën për këto materiale.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A do ta përdorni rregullin  
13 106 në ndonjë fazë sa i takon këtyre materialeve?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po, dhe e kemi përdorur dhe kjo ka  
15 lidhje dhe me vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që  
16 ka lejuar mosnxjerrjen e tre paketave në veçanti. Por ajo për  
17 të cilën ne flasim tani, është se nga që ka një vendim  
18 procedural për paketat është një tërësi tjetër materialesh, jo  
19 të gjitha janë produkte të brendshme pune po disa prej tyre  
20 janë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua që t'i kthehem tani  
22 qëllimit të rregullit 106, arsyeja pse ekziston privilegji për  
23 produktet e brendshme të punës. A do të mendonit se qëllimi i  
24 këtij rregulli në një farë mënyre është i parëndësishëm në  
25 momentin kur këto produkte të brendshme të punës kanë dalë

1 tashmë në publik, si pasojë e asaj që ju pretendoni, se është  
2 aktivitet kriminal?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Jo. Do t'ju përgjigjem, do t'jua  
4 shpjegoj. Produktet tona të brendshme të punës mund të mos  
5 quhen më të tilla kur jua japim palëve të treta. Por nuk është  
6 ky rasti për materialet për të cilat po flasim. ZPS-ja nuk ka  
7 hequr kurrë dorë nga e drejta për këto produkte të brendshme  
8 pune. Nëse ato nxirren në publik në mënyrë të paligjshme, kjo  
9 nuk do të thotë se kjo ua heq natyrën si produkt pune, si  
10 produkt i brendshëm pune, pra kjo, dua të them, kjo natyrë nuk  
11 ndryshon nga aktiviteti kriminal.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ky material, kur del në  
13 publik, a nuk përbën thelbin e krimit që ju pretendoni se  
14 është kryer? Sepse ka fituar një natyrë komplet tjetër, nëse  
15 do të thosha kështu. Është bërë pjesë e elementit të krimit.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Jo ende jo, sepse nuk është në  
17 publik. Diçka që përhapet në mënyrë të paligjshme dhe këtu dua  
18 të them, se jo çdo gjë që nxirret në mënyrë të paligjshme  
19 mbetet në publik p.sh., ka faqe nga paketa tre, të cilat  
20 vërtetë janë shpërndarë, po jo me doemos kanë dalë në artikuj,  
21 në media apo në vende të tjera.

22 Pra, kur kemi një situatë të tillë, vetë dokumenti nuk e  
23 ka humbur natyrën për shkak se është shpërndarë. Asnjë  
24 informacion që ndodhet në atë dokument nuk ndodhet në publik,  
25 nuk gjendet në publik. Ne nuk mund ta humbasim mbrojtjen e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 40

1 produktit të brendshëm të punës për këtë arsye. Pra, një krim  
2 nuk mund ta zhveshë këtë material nga ky privilegj, siç e keni  
3 përshkruar ju.

4 Por ky diskutim gjithsesi është ndryshe nga diskutimi për  
5 të cilin ne po flasim. Po flasim për materiale të ndryshëm dhe  
6 në seancën *ex-parte* mbase do jetë më e qartë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.  
8 Faleminderit, z. kryetar.

9 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Dua t'ju jap mundësinë që të  
10 përgjigjeni për ato që janë thënë deri tani në seancë të  
11 hapur, nëse është e mundur.

12 Z. Rees.

13 Z. REES: [Përkthim] Dua të rezervoj të drejtën ta shpreh  
14 më vonë qëndrimin tonë kur të rimblidhemi.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë kam të njëjtin qëndrim.

16 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të ritakohemi në orën  
17 14:00, kështu sikur na e kërkuat. Pra në orën 14:00. Të  
18 jeni...

19 Një moment, ju lutem.

20 [Anëtarët e trupit gjykues këshillohen midis tyre]

21 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do të rimblidhemi në orën  
22 14:00. Prokuroria duhet të jetë e përgatitur për të kaluar në  
23 seancë *ex-parte*, menjëherë pas asaj seance nëse do ta lejojmë  
24 këtë gjë. Faleminderit.

25 --- Pushimi i drekës fillon në orën 11.21



1 --- Seanca rifillon në orën 13.59

2 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve! Jemi  
3 rikthyer në seancë për të dëgjuar parashtrimet e Mbrojtjes për  
4 njoftimin e hollësishëm apo listën e rregullës 102(3).

5 Z. Rees, fjalën e keni ju.

6 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit! Do të doja që të  
7 filloja me qëndrimin e djeshëm të ZPS-së. Dje Trupit Gjykses  
8 iu tha se në përgjigje të urdhrin gojarisht që dhatë ju, se  
9 nëse ZPS-ja do të mbajë qëndrimin se përditësimi i njoftimit  
10 të rregullës 102(3) do të kërkonte zbulimin e informacionit që  
11 është objekt i masave mbrojtëse, qoftë edhe në listë, është në  
12 objektin e dokumentit informues të Dhomave që t'i kërkojë  
13 Dhomës një vendim lidhur me këtë brenda datës 6.

14 Dje, ZPS-ja nuk ishte e sigurt nëse në një material do të  
15 kërkonte një masë të tillë dhe të vetmet masa që janë duke u  
16 menduar janë masat sipas rregullës 80. Sigurisht, rregulla 80  
17 kërkon shqyrtimin e masave mbrojtëse për Mbrojtjen, sigurinë,  
18 mirëqenien fizike dhe psikologjike të dëshmitarëve dhe  
19 personave të tjerë, të cilët rrezikohen nga dëshmia e dhënë  
20 nga dëshmitarët.

21 Pra, ka të bëjë në mënyrë të veçantë për përdorimin e  
22 materialit gjatë gjykimit dhe sigurisht rregulla 80 i kërkon  
23 si palës kërkuese ashtu edhe gjykatës që të mendojë natyrën e  
24 masës që kërkohet, sidomos me qëllim që të sigurohet që çdo  
25 ndërhyrje në procesin normal të gjykimit të mbahet në një

1 nivel sa më minimal të nevojshëm dhe sigurisht kjo do të ishin  
2 masa të kufizuara siç është redaktimi i emrave, përdorimi i  
3 pseudonimeve, mosnxjerrja për publikun, fshirja e  
4 informacionit nga dokumentacioni publik i Dhomave të  
5 Specializuara dhe kështu me radhë. Përdorimi i seancave të  
6 mbyllura dhe private janë mënyra të cilat u japin zgjidhje  
7 rreziqeve të tilla. Dhe sigurisht kufizimi mbi nxjerrjen e  
8 mëtutjeshme dhe të përdorimit të tij.

9         Sot, na thuhet se në fakt, ZPS-ja tani duket se do të  
10 ndjekë një qasje përgjithësuese, kështu them, duket sepse  
11 emaili që kemi marrë në orën 10.35 sot nuk jep ndonjë  
12 indikacion të vërtetë për t'u kuptuar se çfarë niveli  
13 ndërhyrjeje do të kërkonte rregulla e artë e nxjerrjes që  
14 kërkon ZPS-ja. Unë thjesht mund të deduktoj dhe deduktimi që  
15 mund të bëj unë është që ZPS-ja kërkon ndjekjen e një qasjeje  
16 përgjithësuese për të gjitha materialet që bihen në objektin e  
17 urdhrit të Trupit Gjykoës të djeshëm, -- urdhrit të djeshëm të  
18 Trupit Gjykoës, ndjesë, pavarësisht nga kërkimi i sqarimit për  
19 qëndrimin dje.

20         Njoftimi shpjegon se ZPS-ja është duke kryer hetime  
21 delikate sa i takon dorëzimit të këtyre paketave. Tani të  
22 ndalojmë këtu. Ia vlen që të shikohet ky pohim, kjo deklaratë,  
23 që hetimi është duke u vazhduar, pavarësisht nga konkluzionet  
24 e guximshme që ka shprehur ZPS-ja në të shkuarën, në seanca të  
25 hapura, që ata ende nuk e kanë arritur mbylljen e hetimeve të

1 tyre. Që në fakt duket sikur ata kërkojnë që të luajnë me  
2 parashtrime të ndryshme të bëra gojarisht, me një mendje të  
3 mbyllur sa i takon vijimit të këtyre hetimeve.

4 Njoftimi vijon po me email për të shpjeguar se ZPS-ja  
5 mendon të jetë cenuese për këtë hetim që të zbulojnë sesi janë  
6 bërë dorëzimet e këtyre paketave, sepse përndryshe mund të  
7 krijoni mundësi për nxjerrje të tjera të paligjshme të  
8 materialeve konfidenciale. Po nuk ka asgjë në email që të  
9 shpjegojë sesi do të ndodhte kjo, si do të krijoheshin këto  
10 mundësi, apo me çfarë ka të bëjë ky informacion konfidencial i  
11 cili u rrezikua që të nxirret.

12 Prokuroria vijon që të shpjegojë se rregulla 108(1) lejon  
13 mosnxjerrjen e informacioneve që janë të nxjerrshme sipas  
14 rregullës 108(2), nëse kjo do të cenonte hetimet e tanishme  
15 dhe të ardhshme.

16 Këtu do të doja që të thosha se në publik Prokurori i  
17 Specializuar, në njoftimet për shtyp dhe intervista në media,  
18 me shumë kënaqësi ka shprehur besimin sesi burimi i këtij  
19 procesi ka çuar në dorëzimin e këtyre informacioneve, e këtyre  
20 provave pra, pavarësisht nga rreziku i cenimit të hetimeve të  
21 tanishme dhe të mëtejshme.

22 Pra, ne na duket se rreziku i cenimit të hetimeve të  
23 tanishme dhe të ardhshme është një faktor që ZPS-ja e përdor  
24 atëherë kur i volit, por nuk e merr parasysh edhe në raste të  
25 tjera kur nuk i volit.

1 Krahas kësaj, emaili thotë se:

2 "Pjesë të materialit përbëjnë dokumente të brendshme të  
3 punës sipas rregullës 106."

4 Por nuk shpjegohet në email se cilat pjesë të këtij  
5 materiali, dhe sa të gjata janë këto pjesët e materialit, nuk  
6 flet për natyrën apo kategorinë e produktit të brendshëm të  
7 punës që do të mbulohej nga rregulla 106.

8 "ZPS-ja nuk ka asnjë detyrim" thotë emaili "që të japë  
9 njoftim për materiale të tilla, të cilat nuk nevojiten të  
10 futen në listën e njoftimit të rregullës 102(3)."

11 ZPS-ja nuk pranon se rregulla 103, më falni, rregulla 106  
12 thotë se, më falni, kërkesa e njoftimit sipas rregullës 102  
13 është objekt i rregullës 106, nëse nuk ka urdhër tjetër nga  
14 Trupi Gjykses. Pra dua që ta nënvizoj se rregulla 106 i jep  
15 kompetencën Trupit Gjykses që të urdhërojë që ky material të  
16 bëhet objekt i nxjerrjes apo njoftimit. Pra, jo vetëm njoftimi  
17 sipas rregullës 103, por edhe sipas rregullës 102(3). Pra kjo  
18 është një kompetencë e gjerë që i jepet Trupit Gjykses.

19 Emaili në fund thotë se:

20 "ZPS-ja do të kërkojë autorizim që të bëjë parashtrime *ex*  
21 *parte* për t'i dhënë Trupit Gjykses hollësi të tjera lidhur me  
22 rreziqet që do të sillte dhënia e njoftimit dhe e hollësive  
23 lidhur me hetimet e brendshme të ZPS-së."

24 Është një parim i përgjithshëm se kur bëhen parashtrime  
25 *ex parte* duhet bërë njoftimi i përshtatshëm Mbrojtjes me atë

1 nivel konkretësie që lejon materiali. Dhe është e nevojshme që  
2 kjo të bëhet në mënyrë që t'i jepet mundësi të fokusuarve që  
3 të japin parashtrime të fokusuara përpara gjykatës. Nuk na  
4 jepet asnjë e njoftimi të tillë. Trupi Gjykses e kërkoi një  
5 njoftim që dje. ZPS-ja kishte gjithë natën në dispozicion,  
6 kishte edhe sot paraditen dhe u mjaftuan vetëm me një diskutim  
7 jo më të gjatë se një minutë përpara se të fillonte seanca  
8 sot. Dhe pastaj hartuan një email aspak të rregullt, i cili  
9 pretendon se respekton urdhrin e Trupit Gjykses, por ai email  
10 nuk sugjeron aspak se ZPS-ja e ka menduar që të na e japë neve  
11 njoftimin sa më konkret që të ishte e mundur në bazë të  
12 materialit, në mënyrë që ne të bëjmë parashtrime të fokusuara  
13 përpara Gjykatës.

14 Unë edhe njëherë -- e nënvizoj -- për shkak të natyrës së  
15 përshpejtuar të kësaj kërkese unë mbështetem në të drejtën e  
16 përgjithshme, pra në jurisprudencën e Anglisë dhe të Uellsit,  
17 ku Gjykata e Apelit e Anglisë dhe e Uellsit është shprehur se:

18 "Duhet që Mbrojtja të vihet në dijeni të informacioneve  
19 dhe të hetimeve që kanë bërë autoritetet hetimore dhe nga  
20 gjykata dhe shqyrtimi që u bën gjykata fakteve që kanë lidhje  
21 me çështjet të cilat janë pjesë e çështjes gjyqësore. Me  
22 konsideratat më të forta lidhur me këtë."

23 Dhe unë e mbështes që ky është parimi i përgjithshëm i  
24 cili duhet zbatuar edhe nga kjo Gjykatë.

25 Ajo që del qartë nga emaili është se materiali që kërkon

1 të mos nxjerrë ZPS-ja duket se është i gjatë. Kjo bie ndesh me  
2 përshtypjen, të paktën me përshtypjen, që u është dhënë, u  
3 është bërë Gjykatësit të procedurës paraprake dhe palëve më  
4 përpara. Për shembull, sa i takon, më falni, më datë 30 mars  
5 të këtij viti në konferencën mbi ecurinë e çështjes që u  
6 zhvillua më këtë datë siç është regjistruar edhe në  
7 procesverbalin në faqen 97, nga rreshti 16 deri në rreshtin  
8 20, z. Pace në emër të Prokurorisë thoshte se:

9 "ZPS-ja, pra siç kemi thënë më përpara, ZPS-ja ka nxjerrë  
10 dhe i kemi informuar përpara informacionet që kemi për hapat  
11 që janë kryer sa i takon identitetit të mundshëm të personit  
12 që i ka lënë këto dokumente në OVL-UÇK. Në veçanti, ka qenë  
13 një intervistë, të cilën ia kemi vënë në dispozicion  
14 Mbrojtjes."

15 Por të paktën, duket që janë treguar shumë dorështrënguar  
16 me të vërtetën siç e shohim tani. Në lidhje me këtë intervistë  
17 meqë ra fjala dhe besoj do ta keni parë edhe se çfarë kemi  
18 thënë në dosjen tonë paraprake si Mbrojtje, kjo intervistë  
19 ishte intervista e bërë pas zbulimit tek një zyrtar i ZPS-së  
20 më datë 16 dhjetor të numrit të indeksit së një automjeti që  
21 duket se ka qenë personi që ka bërë dorëzimin më atë datë.

22 Siç e kemi thënë edhe në dosjen tonë paraprake, zyrtari i  
23 ZPS-së duket se nuk ka qenë i interesuar për këtë informacion  
24 dhe si të thuash u detyrua që ta merrte këtë dhe na u dha  
25 përshtypja se nuk është bërë orvatje për ta kontrolluar këtë

1 numër indeksi deri më datë 25 nëntor 2020 dhe vetëm më datë 18  
2 dhjetor 2020, kur z. James Pace e intervistoi këtë person. Një  
3 intervistë e cila na është nxjerrë, na është dhënë dhe ne e  
4 kemi, e kishim emrin e dëshmitarit. Pra, emri i dëshmitarit na  
5 u zbulua. Unë nuk do ta përmend me emër, por duket se në atë  
6 etapë nuk kishte ndonjë shqetësim sa i takon zbulimit të  
7 hollësive të hetimit për procesin përmes së cilit janë  
8 dorëzuar këto paketa në OVL-UÇK. Ndaj që shikojmë në këtë  
9 intervistë kaq të shkurtër është se personi i ka konfirmuar z.  
10 Pace në fakt se ishte automjeti i tij.

11 Ajo që mund të themi nga ajo intervistë kaq e shkurtër,  
12 të cilën ne kemi pasur mundësi që ta shikojmë, duket se është  
13 një intervistë e bërë shkel e shko dhe duket se ZPS-ja nuk ka  
14 pasur ndonjë interes për ta zhbiruar më me intësi dhe më me  
15 kujdes këtë pistë hetimi. Po kështu sot më herët, na u tha se  
16 Gjykatësi i procedurës paraprake në vendimin e tij lidhur me  
17 kërkesën e Prokurorisë dhe kundërshtimet që janë bërë pas  
18 dokumentit F-172 ka vendosur për një kërkesë për ne, që një  
19 njoftim sipas rregullës 102(3) ishte i mangët. Por në fakt ai  
20 nuk ka marrë vendim për këtë, ai mori vendim vetëm për një  
21 aspekt.

22 Ai, del qartë, në paragrafin 58 ka marrë vendim për  
23 provat që kishim neve dhe kjo çështje ishte nëse ky material  
24 do të duhej që të nxirrej sipas rregullës 102(3) apo sipas  
25 rregullës 103 të rregullores. Dhe kjo del qartë sipas

1 paragrafit 58 të vendimit të tij dhe në paragrafin 64 të  
2 vendimit të fundit.

3 ZPS-ja me dashje apo pa dashje, bën deklarata të cilat  
4 janë të pasakta dhe unë do t'ju lutesha të tregonit kujdes si  
5 Trup Gjykses, që të mos mbështeteni në këto deklarata të tyre  
6 pa i shqyrtuar mirë. Vendimi i apelit kundër nxjerrjes është  
7 dokumenti me numër IA-005, flet për historikun e nxjerrjeve  
8 për këto çështje. Ky historik nëse më lejoni do të doja që t'i  
9 bëja një përmbledhje, sepse demonstroi atë që ne themi se  
10 është një qasje ndaj detyrimeve të nxjerrjes nga ana e ZPS-së,  
11 e cila nuk karakterizohet nga një angazhim konstruktiv, por  
12 karakterizohet nga një qasje shmangëse.

13 Ato gjithmonë përpiqen që të shikojnë sesi t'u shmangen  
14 detyrimeve dhe jo sesi të angazhohen për përmbushjen e këtyre  
15 detyrimeve. Që në fillim sa i takon objektit të rregullës  
16 102(3) ne parashtronim se rregulla 102(3) krijonte një proces  
17 me disa hapa që ishte diçka e re dhe që nuk reflektohej nga  
18 tribunalët e tjerë ndërkombëtarë në këtë qytet. Dhe kishim të  
19 drejtë për këtë, pavarësisht nga kundërshtimet që bënte ZPS-ja  
20 për këtë parashtrim tonin. Është një proces me disa hapa. Hapi  
21 i parë i cili kërkon që ZPS-ja të japë njoftim të hollësishëm  
22 për çdo material apo prova që ka në zotërim dhe të cilat janë  
23 të rëndësishme për çështjen.

24 Gjykata e Apelit njësoj si Gjykatësi i procedurës  
25 paraprake pajtohej me parashtrimet tona se koncepti i



1 rëndësisë për çështjen duhet të interpretohet në mënyrë të  
2 përgjithshme dhe të gjerësishme dhe se testi i rëndësisë në  
3 funksion të kësaj, në funksion të këtij hapi të parë nuk është  
4 testi që bëjnë gjykatat e tjera sepse nuk e kanë këtë hap.  
5 Testi që bëjnë në këtë rast është më i gjerë sesa testi i  
6 materialitetit për përgatitjen e Mbrojtjes dhe përfshin disa  
7 hapa. ZPS-ja në fakt, duket se edhe sot e kësaj dite nuk e  
8 ndjek këtë interpretim që ka bërë edhe Gjykata e Apelit njësoj  
9 si Gjykatësi i procedurës paraprake.

10 Në dallim nga qasja që ka ndjekur ZPS-ja, rëndësia për  
11 çështjen siç ka thënë Gjykata e Apelit dhe siç kemi  
12 parashtruar dhe ne, nuk ka të bëjë vetëm me objektin e akuzave  
13 kundër të akuzuarit. Konkretisht në dallim nga qasja e  
14 vendosur që ka ndjekur ZPS-ja, procesi përmes të cilit kanë  
15 shkuar informacionet në mjedise të OVL-UÇK-së është me rëndësi  
16 siç kemi parashtruar ne që në fillim. ZPS-ja kë dhënë dy  
17 versione të njoftimit të rregullës 102(3) në të shkuarën:

18 Versioni i parë i datës 19 shkurt 2021, i protokolluar me  
19 nr. F-133 në shtojcën 1, kishte 13 materiale. Ne në atë fazë  
20 thamë se ishte një përpjekje e dobët për të respektuar  
21 detyrimet e rregullës 102(3) dhe ne kishim të drejtë. ZPS-ja  
22 kishte përgatitur atë version të parë vetëm me tre materiale  
23 dhe ata pretendonin se kjo ishte plotësisht në përputhje me  
24 detyrimet e nxjerrjes, por e kishin gabim.

25 Siç vendosi Gjykatësi i procedurës paraprake, ata kishin

1 lënë jashtë 171 materiale, shumica kryesore e të gjithave siç  
2 del iu nxorën më pas Mbrojtjes, pasi u zbulua ekzistenca e  
3 tyre dhe përmbajtja e së cilës u informua vetëm përmes një  
4 njoftimi, të cilin ne e kërkuam përmes një argumentimi. Kur ne  
5 e morëm dhe patëm mundësi që ta shikojmë dhe të argumentonim  
6 se duhej që të nxirrej i gjithi si material me rëndësi për ne  
7 apo si material shfajësues.

8           Versioni i dytë dhe i fundit në përputhje me urdhrin e  
9 Trupit Gjykses dje është një version i dytë dhe përfundimtar  
10 sipas rregullës 102(3) në lidhje me materialet dhe  
11 informacionet që ka në zotërim ZPS-ja, ku përsëri informacioni  
12 sesi këto paketa kanë shkuar në mjediset e OVL-UÇK-së nuk janë  
13 përfshirë aty.

14           Siç vendosi Trupi Gjykses dje, ZPS-ja duhet që ta  
15 rishikojë njoftimin e rregullës 102(3), në mënyrë që çdo  
16 informacion material në zotërim të ZPS-së lidhur me procesin  
17 përmes të cilit informacionet i kanë shkuar në mjediset e OVL-  
18 UÇK-së duhet që të listohen në njoftimin e rregullës 102(3),  
19 me përjashtim të rastit kur Trupi Gjykses autorizon të  
20 kundërtën e kësaj në përputhje me regjimin ligjor.

21           Në veçanti, Gjykata e Apelit është shprehur se krahas  
22 kësaj qasjeje të përgjithshme që çdo informacion material në  
23 zotërim të ZPS-së, që ka të bëjë me procesin në mes të cilit  
24 kanë shkuar këto informacione në mjediset të OVL-UÇK-së, duhet  
25 që të bëjë pjesë në këtë njoftim dhe që kanë qenë në objektin

1 e kërkesës B dhe C të Guccatit është me rëndësi dhe duhet të  
2 përfshihet në njoftimin e rishikuar sipas paragrafit 57.

3 Unë po e vijoj ta jap këtë historik se në mungesë të një  
4 njoftimi të rregullt dhe në mungesë të njoftimit sipas  
5 rregullës 102(3) që do të duhej që të rishikohej në përputhje  
6 me urdhrin që ka dhënë Trupi i nderuar Gjykues, ku të tregohet  
7 se cilat janë redaktimet e propozuara dhe ku të jetë në  
8 përputhje me rregullën e përgjithshme, rregullën e artë që  
9 është nxjerrja e plotë, ZPS-ja këtë mund ta kishte bërë. Po ta  
10 kishte bërë ZPS-ja madje, ne do të kishim informacion sesa  
11 materiale janë, çfarë materiale mund të renditen në njoftimin  
12 e rregullës 102(3). Po ne këtë nuk e kemi, nuk e kemi  
13 dokumentin e plotë.

14 Mua më duket se ka rëndësi që ZPS-ja t'i shikojë këto me  
15 rëndësi se ata nuk kërkojnë për dokumente të brendshme pune  
16 apo raporte, ata kërkojnë informacion, bëjnë fjalë për  
17 informacion. Dhe ka dallim midis dokumentacionit të brendshëm  
18 të punës dhe informacionet në bazë të të cilave janë përpiluar  
19 dokumentet e brendshme të punës. Siç e shikon në rregullën  
20 106, aty nuk përjashtohet nga detyrimet e nxjerrjes për  
21 informacione mbi të cilat bazohen raportet. Raporti vetë mund  
22 të jetë i mbrojtur sepse mund të ketë gjëra të tjera, për  
23 shembull, opinionin, mendimin e zyrtarit të ZPS-së. Dhe me thënë  
24 të drejtën mua s'më interesojnë fare mendimet e ZPS-së, e  
25 punonjësve të ZPS-së.

1           Mua më interesojnë informacionet dhe faktet, në bazë të  
2 të cilave janë mbështetur këto raporte dhe ato nuk mbulohen  
3 nga rregulla 106, prandaj duhet të ishin përfshirë në  
4 njoftimin sipas rregullës 102(3).

5           Prandaj ne kemi kërkuar në kërkesën B të Gucatit që të na  
6 jepeshin të gjitha informacionet që ka ZPS-ja lidhur me  
7 procesin sesi kanë shkuar këto paketa në mjediset e OVL-UÇK-  
8 së.

9           Unë e pranoj që një raport mbi këtë informacion mund të  
10 ishte pjesë e rregullës 106, sipas kërkesës B dhe C të  
11 Gucatit. Ama informacioni nuk është pjesë e kësaj rregulle.

12           Po kështu sipas kërkesës të gjitha materialet dhe  
13 informacionet që ka përdorur Prokuroria për të zbuluar.

14           GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] I nderuar Avokat duhet të  
15 ngadalësoni kur të lexoni.

16           Z. REES: [Përkthim] Faleminderit! Ju lutem mund të më  
17 ndaloni përsëri nëse nuk ngadalësoj.

18           Pra, edhe njëherë kërkesa C e Gucatit, ishte që të gjitha  
19 materialet që mban Prokuroria, të cilat kanë të bëjnë me  
20 orvatjet e Prokurorisë për të gjurmuar personat që kanë bërë  
21 nxjerrjen e tre paketave në OVL-UÇK.

22           Edhe njëherë e pranoj se mund të ketë disa raporte të  
23 cilat mund të jenë pjesë e kësaj kategorie, por janë  
24 informacionet bazë që janë të nxjerrshme dhe që nuk i mbulon  
25 rregulla 106. Por, kjo kërkesë shkonte më tej, shkonte përtej

1 këtyre kategorive. Sigurisht janë hartuar në një kohë kur neve  
2 nuk e kishim njoftimin sipas rregullës 102(3) siç e ka pranuar  
3 edhe Gjykata e Apelit. Ato ishin hartuar me nxitjen e  
4 Gjykatësit të procedurës paraprake, i cili edhe pse vendosi  
5 pro kërkesës sonë, pro parashtrimt tonë asokohe. Pra,  
6 Gjykatësi i procedurës paraprake për të përshpejtuar  
7 procedurën i tha Mbrojtjes që kur të merrni njoftimin e  
8 përditësuar sipas rregullës 102(3) dhe nëse aty ka materiale  
9 të cilat duhet të jenë por nuk janë, mos u shqetësoni për  
10 njoftimin e rregullës 102(3), na kontaktoni dhe kërkoni  
11 nxjerrjen e këtyre materialeve. Dhe nëse ka materialitet dhe  
12 përmbushet ky kriter atëherë do t'ju nxirret.

13 Kemi kaluar tani nga hapi një në hapin tre, pa përfunduar  
14 siç duhet procesin e etapës një dhe të etapës dy. Por ne kemi  
15 bërë çmos që të përpiqemi që të jemi sa më specifikë.

16 Dhe kërkesa përfshin edhe sa vijon në lidhje me  
17 materialin të identifikuar si "paketa tre", që thuhet se  
18 përbëhet nga dy kopje jo të plota, 234-235 është numri i  
19 faqeve që ka të bëjë me hetimet dhe procedurat zyrtare të  
20 ZPS-së dhe që përbën një produkt të brendshëm pune të datës 19  
21 dhjetor, por më pas thuhet se i përket datës 15 mars 2020, që  
22 përfshin edhe punonjësit e ZPS-së që kanë kontribuar në  
23 hetimet e saj. Ne nuk kërkojmë raport apo produkt të brendshëm  
24 pune. Kërkojmë informacion.

25 Cilët punonjës të tanishëm apo të shkuar kanë pasur

1 mundësi, kanë pasur qasje elektronike te dokumentet e punës?  
2 Ne nuk kërkojmë dokumentet e punës apo aktet e tyre të  
3 brendshme. Ne kërkojmë informacion.

4 Cilët punonjës të tanishëm apo të shkuar kanë kryer  
5 hetime dhe dokumente, qoftë elektronike apo në format/letër të  
6 shtypur. Edhe këtu nuk kërkojmë ato dokumente, por kërkojmë  
7 informacion.

8 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees, a mund ta mbyllni  
9 pas 5 minutash? E kemi kohën e kufizuar dhe nesër nuk mund të  
10 vijojmë.

11 Z. REES: [Përkthim] Ju kuptoj. Do përpiqem. Pesë minuta  
12 nuk ka gjasa, por duke pasur parasysh që është një parashtrim  
13 i bërë gojarisht, që po e bëjmë me detyrim. Unë nuk kam dhe  
14 shumë gjëra që të them, po ca gjëra dua t'i them.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Atëherë thoni më të  
16 rëndësishmet. Një moment. Z. Cadman ka diçka për të thënë.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Për hir të kohës dhe padashur që të  
18 përsëris ato që ka thënë me hollësi z. Rees, unë kohën time do  
19 t'ja jepja z. Rees.

20 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Ai në kohën tuaj ka hyrë  
21 tashmë. Z. Rees, mund të vijoni.

22 Z. REES: [Përkthim] Do përpiqem të jem sa më konciz.

23 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] E di, e di, kam besim.

24 Z. REES: [Përkthim] Po unë këtë listë dua ta përmend  
25 sepse duket se ZPS-ja nuk ia vë veshin kurrë kërkesës sonë për

1 t'i kushtuar rëndësi këtyre çështjeve, e shpërfillin  
2 gjithmonë. Ata e bëjnë kërkesën tani, bëjnë një kërkesë e cila  
3 nuk përputhet me vendimin e Gjykatës së Apelit dhe me çështjet  
4 që ne kemi ngritur përpara.

5 Ne nuk kërkojmë dokumente të brendshme, as raporte, as  
6 akte të tyre të brendshme, ne nuk kërkojmë dokumente të  
7 mbrojtura, kërkojmë vetëm informacione.

8 Cilët janë punonjësit, kanë pasur të drejtë, kanë pasur  
9 fjalëkalim për të hyrë në këto dokumente. Cilët kanë qenë  
10 punonjësit që kanë pasur qasje në këto dokumente pa fjalëkalim  
11 apo kishin ndonjë fjalëkalim të tillë?

12 A e ka ZPS-ja ende një kopje elektronike të këtyre  
13 dokumenteve? A e ka identifikuar ZPS-ja kompjuterin se nga  
14 është krijuar ky dokument?

15 Kush janë apo kush kanë qenë përdoruesit e rregullt të  
16 këtyre kompjuterave? Këto janë informacionet dhe faktet që ne  
17 kërkojmë. Nuk kërkojmë raporte apo akte të brendshme.

18 Sa punonjës të tanishëm apo të mëparshëm të ZPS-së janë  
19 intervistuar lidhur me nxjerrjen e këtyre dokumenteve?

20 Sa punonjës të tillë janë intervistuar për nxjerrjen e  
21 dokumenteve?

22 Sa pajisje elektronike janë përdorur apo të kontrolluara  
23 nga punonjësit e tyre dhe janë marrë në këqyrje për këtë?

24 Sa llogari të postës elektronike apo mundësi të  
25 komunikimit në distancë janë këqyrur nga ZPS-ja?

1 A janë ruajtur në mjediset e ZPS-së kopje në letër, a ka  
2 pasur kamera të sigurisë, të cilat janë këqyrur? Nëse po, sa  
3 të tilla dhe në cilat zona?

4 Gjykata e Apelit binte dakord se ky material është i  
5 rëndësishëm, jo raportet, jo opinionet e punonjësve të ZPS-së,  
6 jo aktet e tyre të brendshme, por këto informacione duhet të  
7 ishin pjesë e listës sipas rregullës 102(3).

8 Megjithatë, nuk janë këto të vetmet pyetje sepse siç e  
9 dimë informacioni i cili ka arritur në ambientet e OVL-UÇK-së  
10 është i gjithi i rëndësishëm, megjithatë specifikimet janë  
11 dhënë në vendimin përkatës së Gjykatës së Apelit.

12 Më lejoni të shtoj po ashtu se gjykata e apelit e ka bërë  
13 shumë të qartë që këto kërkesa përderisa janë të rëndësishme  
14 duhet që të rishikohen për nxjerrje, jo vetëm sa i takon  
15 aspektit të provokimit ose të nxitjes dhe shtytjes së dhënies  
16 së informacionit, megjithatë, d.m.th. nuk mund ta ndihmoj dot  
17 Prokurorinë, përderisa ne nuk dimë fare se çfarë lloj  
18 informacioni ekziston.

19 Megjithatë, n.q.s. do të futemi në shtjellimet *ex parte*,  
20 ZPS-ja dhe juve, Trupi Gjykses pra duhet që të shqyrtojë,  
21 duhet që të shikojë të gjitha përdorimet e mundshme apo të  
22 gjitha rëndësitë e mundshme të dokumentacionit të tillë për  
23 Mbrojtjen, dhe jo vetëm të lidhur me çështjen e shtytjes për  
24 kryerjen e veprës penale.

25 Sugjerimi i ZPS-së sot paradite dhe siç e thatë edhe juve



1 të nderuar Gjykatës, se ata kanë bërë një lexim interesant të  
2 vendimit të Gjykatës së Apelit. Pra vendimi i Gjykatës së  
3 Apelit ishte përfundimtar, edhe si rezultat ZPS-ja nuk bëri  
4 asgjë lidhur me mosveprimin për nxjerrjen e informacionit nga  
5 ana e ZPS-së të identifikuar në vendimin e Gjykatës së Apelit.

6 Kjo na sugjeron apo na konfirmon një lloj modeli  
7 sjelljeje, d.m.th. që ZPS-ja ka modelin e shmangies ose  
8 mosangazhimit me ne.

9 Gjykata e Apelit ka cilësuar që mbështetur në  
10 informacionin e Gjykatësit e procedurës paraprake mbi atë bazë  
11 që nuk ishte e gabuar që të refuzonte nxjerrje, sepse ne kemi  
12 kaluar nga faza një deri në fazën tre, d.m.th. pa përfunduar  
13 ende fazën e parë është kaluar në fazën e tretë. Dhe si  
14 rezultat është kërkuar ndihmë për aplikimet e nxjerrjeve pa u  
15 mbështetur në rregullën 102(3).

16 Ajo çfarë ka bërë të qartë Gjykata e Apelit dhe kjo  
17 është e qartë në vendim është që i kujtoi ZPS-së që kjo  
18 parashikohet në fakt në paragrafin 53 dhe është edhe pjesë e  
19 njoftimit sipas rregullës 112 që detyrimet për nxjerrje për  
20 ZPS-në janë të një natyre të vazhdueshme.

21 Megjithatë në bazë të ndërmjetme kur Gjykata e Apelit e  
22 di që çështjet do t'i çohen, le të themi, do t'i kthehen  
23 mbrapsht Gjykatësit të procedurës paraprake dhe pastaj Trupit  
24 Gjykues, atëherë i ka kujtuar sërish ZPS-së nevojën për të  
25 respektuar rregullën 102(3) gjatë gjithë procesit gjyqësor

1 edhe pas gjykimit. Më lini të shprehem ndryshe, pra duket  
2 sikur ZPS-ja është e kënaqur që Mbrojtja vazhdon që të ketë  
3 barrën e identifikimit në abstraktin e mungesave të listave,  
4 pavarësisht faktit që i gjithë informacioni duhet që të na  
5 ishte vënë në dispozicion.

6 Pra duket sikur ZPS-ja është e lumtur me këtë lloj  
7 pozicioni, pra ZPS-ja duket sikur është e kënaqur që Mbrojtja  
8 të vazhdojë që t'i mohohet përfitimi nga një njoftim i tillë,  
9 duke pasur një barrë më të madhe dhe duke e pasur më të  
10 vështirë për të vijuar dhe për të pasur informacion që e ka në  
11 posedim, e ka në zotërim ZPS-ja.

12 Pra me fjalë të tjera, duket sikur ZPS-ja është e kënaqur  
13 që Mbrojtja vazhdon që të vuaj nga një deprivim i tillë. ZPS-  
14 ja po duket sikur është absolutisht e kënaqur që neve  
15 vazhdojmë që të mos kemi të përmbushur fazën e parë të  
16 rregullës 102(3). Dhe propozimi i cili u përsërit sot është  
17 bërë dhe përpara Gjykatësit të procedurës paraprake, që lista  
18 e çështjeve nën rregullën 102(3) është pa objekt dhe duket  
19 sikur ato nuk janë material për përgatitjen e Mbrojtjes.  
20 Megjithatë ky propozim siç e thashë dhe me lart është ngritur  
21 dhe Gjykata e Apelit e ka refuzuar atë qartazi.

22 Në qoftë se detyrimet sipas rregullës 102(3) është që të  
23 listojmë të gjitha materialet përkatëse të rëndësishme, këtë  
24 gjë duhet të bëjë ZPS-ja. Kundërshtimi i këtij propozimi në  
25 fakt përmendet në paragrafin 46 të vendimit të Gjykatës së

1 Apelit.

2 Ne parashtrojmë që ZPS-ja duhet të respektojë plotësisht  
3 vendimin e dhënë prej jush të nderuar Gjykatës, vendimin e  
4 djeshëm, gjithashtu edhe të rishikojë njoftimin sipas  
5 rregullës 102(3) duke dhënë gjithë informacionin që ne kemi  
6 kërkuar, dhe mendoj që faza e parë fare e nxjerrjes duhet që  
7 të paktën në këtë fazë të vonë, le të themi, të procesit  
8 gjyqësor, duhet të përmbushet nga ZPS-ja.

9 Pra ky është hapi pasues i cili do të çonte në  
10 përfundimin e fazës së parë të nxjerrjes.

11 Bazuar në rregullën 108, ZPS-ja sërish na duket neve të  
12 paktën, mbi bazën e emailit shumë të shkurtër që kemi marrë,  
13 pra, sërish ZPS-ja shkel parimet e njoftimit të cilat janë të  
14 parashikuara nën rregullën 102(3) sa i takon nxjerrjes, se  
15 rregulla 102(3) i referohet materialit që është objekt  
16 nxjerrjeje.

17 Pra rregulla 108 mbështetet në materialet të cilat janë  
18 objekt nxjerrjeje mbështetur në rregullën 102. Mbështetur në  
19 rregullën 108, sigurisht, materiali mund të mbahet pjesërisht  
20 ose plotësisht. Megjithatë, ne nuk është se jemi ndihmuar nga  
21 ZPS-ja duke na thënë që ata e kanë mbajtur, do ta mbajnë  
22 informacionin pjesërisht apo plotësisht. Dhe megjithëse kemi  
23 kërkuar një fazë më të hershme për nxjerrjen e këtij  
24 informacioni dhe unë e njoh, e pranoj vendimin e Gjykatës së  
25 Apelit, çfarë do të thotë që unë duhet ta mbaj dosjen time

1 derisa të marr njoftimin sipas rregullës 102(3).

2 Sërish në parashtrimet me respekt neve nga ana e ZPS-së  
3 drejtohemi që të kalojmë, që të kapërcejmë tek faza e tretë  
4 sepse ata duket sikur mbështeten te rregulla 108 për  
5 autorizimin e mosnxjerrjes.

6 Unë nuk e di sepse emaili që kemi marrë nuk shprehet  
7 lidhur me këtë, por nuk e di në qoftë se Prokurori i  
8 Specializuar do të propozojë masa kundërbalancuese. Nuk e di  
9 në qoftë se Prokurori i Specializuar specifikisht do të shohë  
10 parashikimet e rregullës 108(2). Këto masa kundërbalancuese  
11 mund të përfshijnë parashtrimin e një përmbledhjeje të  
12 informacionit të kërkuar prej nesh ose ofrimin e informacionit  
13 në mënyrë të redaktuar dhe siç e thashë pak më përpara këto  
14 janë mënyra më e drejtë nga ZPS-ja në fakt do të ishte që të  
15 njihte, të pranonte kritikën që janë parashtruar nga Gjykata e  
16 Apelit dhe të parashikonte, të shkruante së pari, dhe pastaj  
17 të na vinte në dispozicion një shtojcë mbështetur në njoftimin  
18 që kërkohej sipas rregullës 102(3). Dhe në atë moment ne do  
19 të kishim pasur një argument specifik lidhur me redaktimet në  
20 fjalë, gjë e cila do ta kishte bërë procesin shumë herë më  
21 konciz ose më të thjeshtë për t'u ndjekur. Dhe ne do ta kishim  
22 pasur shumë herë më të thjeshtë për tu përfshirë në procedura,  
23 dhe më konkrete punën tonë, jo në mënyrë të përgjithshme.

24 Nuk e di n.q.s. ka masa të propozuara kundërbalancuese që  
25 do të sugjerohen prej ZPS-së.

1 Ndërkohë sa i takon rregullës 106, siç e thashë dhe siç e  
2 ka injoruar ZPS-ja është shumë e qartë mbështetur në rregullën  
3 106, që Trupi Gjykses ka të drejtën që të urdhërojë nxjerrjen  
4 dhe njoftimin e materialeve të tjera edhe n.q.s. këto  
5 materiale bihen pra, në fushën e veprimit të rregullës 106.

6 Dhe ashtu siç u kujtua prej jush të nderuar Gjykatës sot  
7 paradite kur ju po e pyesnit Z. Halling për nxjerrjen e  
8 materialit në fushën, në domainin publik dua të them që në  
9 përputhje me parashtrimet e mia, informacioni bazë qëndron mbi  
10 një njoftim të brendshëm ose mbi dokumentet e punës nuk është  
11 se përfshihen nën rregullën 106, siç mund të përfshihen në një  
12 raport të tillë.

13 Megjithatë, një material i tillë n.q.s. bëhet publik,  
14 atëherë ky njoftim i brendshëm nuk është se bie më nën  
15 fushëveprimin e rregullës numër 6. Kështu që unë personalisht  
16 do të mbështetesha tek e drejta, kompetenca, dhe më lejoni që  
17 ta gërmëzoj, "N-i-y-i-t-e-g-e-k-a".

18 Pra nuk e di n.q.s. ju keni akses, keni qasje në  
19 Udhëzuesin e Punës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Mendoj që  
20 ky është edicioni i pestë, i referohem edicionit të pestë, do  
21 të mund të që të shikoni referencë ndaj saj dhe një propozimi  
22 lidhur me një pyetje që bëhet për sa i takon, le të themi një  
23 pyetje që i drejtohet dëshmitarit dhe kur jepet përkufizimi  
24 sesi një dokument nuk mund të quhet më dokument, i cili  
25 mbrohet nën rregulla të caktuara n.q.s. ai është bërë i ditur

1 për publikun.

2 Atëherë më duket sikur e kam fjalën për Mbrojtjen që  
3 parashikohet në rregullën 70(A) të rregullores së gjykatës që  
4 përmenda më sipër përpara ICTR-së.

5 Jam thujse drejt përfundimit të parashtrimeve të mia,  
6 megjithatë kam dhe diçka tjetër që do të adresoja dhe e kam  
7 fjalën për prezumimin e mirëbesimit, për të cilin flet vendimi  
8 i Gjykatës së Apelit. Çdo prezumim i mirëbesimit nga ana e  
9 ZPS-së kur përmbush detyrimet e nxjerrjes është i  
10 prapësueshëm. Për shembull n.q.s. Prokurori refuzon me  
11 vullnetin e vet që të keqlexojë një vendim të Gjykatës së  
12 Apelit, dhe që të trajtojë mosveprimet, të cilat kanë të bëjnë  
13 me punën e vet, atëherë një refuzim i tillë mund të çojë në  
14 prapësimin e një prezumimi të tillë. Dhe siç e demonstrova dhe  
15 më përpara, ZPS-ja u tha që, ZPS-ja nuk ka pikë gatishmërie që  
16 të trajtojë mosveprimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës  
17 së Apelit.

18 Së fundi, pra nuk kemi prezumimin e kompetencës. Një gjë  
19 e tillë nuk paraqitet në rregullore, ndërkohë që ZPS-ja në  
20 mënyrë të vazhdueshme i ka keqinterpretuar detyrimet për  
21 nxjerrje ose në mënyrë të qëllimshme ose jo, dhe thjesht ka  
22 përdorur një qasje shumë të ngushtë sa i takon nxjerrjes. Pra  
23 së pari në mirëbesim ose jo pra duke informuar Gjykatën që  
24 është bërë njoftimi sipas rregullës 102(3) të 13 dokumenteve  
25 përkatëse dhe gjithashtu edhe duke iu referuar paketave të

1 informacionit që kanë arritur në OVL-UÇK, në ambientet e OVL-  
2 UÇK-së si jo të rëndësishme dhe se nuk ka informacion për sa i  
3 takon shtytjes për vepër penale.

4 Në fakt të gjitha këto janë parashtrime pakuptim, sepse  
5 ZPS-ja nuk ka parashikuar ndonjëherë n.q.s. e kupton  
6 fushëveprimin dhe kufizimet sa i takon efekteve të  
7 jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut  
8 dhe nxitjes së policisë. Dje në fakt iu tha juve të nderuar  
9 Gjykatës, që ky kuadër nuk ka rëndësi fare për kuadrin apo  
10 kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

11 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Z. Rees ju lutem, më duhet të  
12 insistoj.

13 Z. REES: [Përkthim] Kam edhe katër rreshta, asnjë fjalë  
14 tjetër më tepër.

15 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po, jua numëroj rreshtat.

16 Z. REES: [Përkthim] Nuk e di kur ata kanë pranuar  
17 propozimin që çdo informacion nga zyrtarë shtetërorë të jetë i  
18 përfshirë në këtë proces, sa i takon mbërritjes së paketave të  
19 informacionit në OVL-UÇK dhe një informacion i tillë do të na  
20 ndihmonte neve për të parë, le të themi elementët rrethorë.

21 Domethënë nuk e di n.q.s. një gjë e tillë është me  
22 rëndësi apo jo, vetëm ajo çfarë di unë është që ZPS-ja ka  
23 thënë qartazi dje, që ligjmërisht këta janë elementë, të cilët  
24 nuk janë me vlerë për ne. Ne sigurisht, ne kemi mbështetje nga  
25 jurisprudenca sa i takon pretendimeve tona në këtë aspekt për

1 shembull në çështjen "Ramanauskas", në paragrafin 72 të këtij  
2 vendimi aktgjykimi thuhet që, "një mohim i thjeshtë i  
3 autoriteteve për shtytje, për nxitje, për kryerjen e një vepre  
4 penale nuk është e mjaftueshme." Dhe për shembull, n.q.s. do  
5 të ishte e mjaftueshme, atëherë nuk do të çonte në ndihmimin e  
6 procesit.

7 Kaq kisha për të thënë, faleminderit.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, nuk dua  
9 që t'ju them që nuk jemi mirënjohës për parashtrimet. Por do  
10 të doja t'ju kërkoja diçka që në të ardhmen ndoshta të lexonit  
11 pak emrin e çështjes kur bëtë citimin për vendimin e Gjykatës  
12 së Apelit të Anglisë dhe Uellsit.

13 Z. REES: [Përkthim] Po, mund t'jua lexoj tani.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po në qoftë se mund të na  
15 jepni dhe numrin e rregullës 70 të Gjykatës Ndërkombëtare që  
16 cituat më përpara.

17 Z. REES: [Përkthim] Numri i faqes është 533, ndërkohë që  
18 sa i takon çështjes apo juridiksionit që përmenda për Anglinë  
19 dhe Uellsin është çështja West [2005] EWCA Crim 517.

20 Ju kërkoj ndjesë që nuk iu referova specificikisht  
21 instrumentit, por iu referova protokollit gjyqësor për  
22 nxjerrjen e materialeve që përdoret në çështjet penale, të  
23 nxjerrë në dhjetor të 2013-s, në paragrafin 55, ku jepet  
24 specifikisht që materiali i cili lejon dhe është i nevojshëm  
25 për të akuzuarin për të bërë parashtrimet e veta përpara



1 gjykatës, atëherë ky informacion duhet të nxirret.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, shumë  
3 shkurtimisht do të doja të thoja që "Ramanauskas" si çështje  
4 është identifikuar në Gjykatën e Apelit. Pra vendimi i  
5 Gjykatës së Apelit thuhet që nuk duket që autoriteti për  
6 propozimin për një agjent provokues nuk është se mund të japë  
7 le të themi shkaqet e arsyeshme për sa i takon shtytjes për  
8 një vepër penale. Pra n.q.s. do të keni jurisprudencë tjetër  
9 relevante, të rëndësishme për agjentët provokues, ju lutem na  
10 e parashtroni atë.

11 Z. REES: [Përkthim] Po, patjetër. Pra n.q.s. ju mendoni  
12 që duhet që të bëjmë parashtrim më të hollësishëm me shkrim,  
13 sigurisht d.m.th. që mund t'ia u paraqesim mendimet tona edhe  
14 me shkrim. Gjithsesi do të doja të thoja që në çështjen  
15 "Ramanauskas", pra thuhet qartë që pavarësisht që personi i  
16 cili është pjesë e një autoriteti, vepron jo nën udhëzimet e  
17 autoritetit përkatës ose të organit përkatës, sërish ai mban  
18 përgjegjësi për atë çfarë ka bërë.

19 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Po, faleminderit

20 Z. REES:[Përkthim] Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Përpara se të më jepni fjalën dhe  
22 të filloj dhe të përgjigjem, nuk e di n.q.s. mund të kalojmë  
23 në seancë me dyer të mbyllura për 20 sekonda.

24 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Nuk e di Vicky n.q.s. mund të  
25 më thuash, n.q.s. mund ta bëjmë shkurtimisht një ndërprerje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë private)

Faqe 66

1 për të kaluar në seancë me dyer të mbyllura?

2 [Seancë private]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë me dyer  
4 të mbyllura të nderuar.

5 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë me dyer të  
6 mbyllura. Z. Halling ju kërkojmë falje! Vetëm thjesht do të  
7 donim që të thonim që një urdhër i redaktuar sa i takon  
8 kërkesës është dërguar me email. Pra thjesht donim ta thonim  
9 këtë në seancë me dyer të mbyllura, ndërkohë që tani mund të  
10 kalojmë në seancë me dyer të hapura.

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë me dyer  
13 të hapura.

14 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

15 Tani do të përpiqem që të mos flas më tepër sesa dy  
16 minuta. Pra ju keni dëgjuar shumë për historinë e nxjerrjes së  
17 lkjlkj;lkjlkjlkjl;kj informacionit në këtë çështje. Jo e  
18 gjitha ajo çfarë ne dëgjuam është e saktë. Megjithatë, për  
19 arsye për të cilat jemi këtu, le të themi se në çfarë pikash  
20 ndodhemi aktualisht.

21 Kjo nuk ka të bëjë me urdhrin që udhëzon ZPS-në për të  
22 bërë parashtrime. Neve folëm për masat mbrojtëse, ndërkohë që  
23 të nderuar Gjykatës juve folët gjithashtu dhe për redaktimet  
24 që kërkohen sipas njoftimit të rregullës 102(3).

25 Ky diskutim nuk ka të bëjë as me emailin që z. Rees e

1 përmendi disa herë. Emaili u dërgua, ka orë që e kanë emailin  
2 në dispozicion, kërkojmë falje dhe njëherë tjetër për këtë  
3 vonesë. Megjithatë dhe emailin ata e kanë tashmë, por e kanë  
4 gjithashtu të gjitha nxjerrjet që kemi bërë.

5 Ky diskutim nuk është as për zhvolumin e materialeve.  
6 Sërish ky qëndrim nuk ka të bëjë me statusin e njoftimit  
7 102(3).

8 Dhe mua personalisht më duket, të them që në faqet 9-10  
9 të transkriptit në kohë reale, z. Rees duke iu referuar  
10 njoftimit 102(3), tha që, ky është njoftimi i dytë dhe i  
11 fundit që lidhet deri me atë çfarë u tha dje dhe ne patëm  
12 përshtypjen që çështja që ngrihet nga rregulla 102(3) është  
13 trajtuar, është zgjidhur nga vendimi i Gjykatës së Apelit.

14 Kur Mbrojtja e Gucatit tha që, një çështje e vetme është  
15 vendosur në këtë vendim, ne donim që të përqendroheshim tek  
16 ajo në veçanti.

17 Në qoftë se Gjykata e Apelit do të kishte vendosur mbi  
18 një çështje të vetme dhe kjo nuk ishte zgjedhur në favor të  
19 Gucatit atëherë apeli nuk do të ishte rrëzuar.

20 Dhe n.q.s. ne do të shikojmë për shembull dokumentin 199,  
21 paragrafi 61, në këtë thuhet që: "Informacioni i kërkuar duhet  
22 nxirret mbështetur në rregullën 103, 102(3) ose të paktën të  
23 listohet në rregullën 102(3)". Vetëm sot po e dëgjojmë që ata  
24 kishin nevojë për njëherë për të bërë tjetrën.

25 Pyetja që shtrohet është: Ku gjendemi tani? Neve e

1 shpjeguar edhe kur bëjmë kërkesën, neve shpjeguar që kjo  
2 gjendet nën rregullën 108, sepse rregulla 108 na bën neve të  
3 mundur që të bëjmë parashtrimet *ex parte*. Kjo nuk do të thotë  
4 që ne po kërkojmë justifikimin për të kaluar hapat, por  
5 aktualisht neve duhet të trajtojmë një çështje që vjen në  
6 rregullën 108, dhe ne kemi të drejtë që t'ja japim këtë  
7 informacion të plotë trupit gjykues.

8 Ky nuk është referendum mbi historikun e nxjerrjes së  
9 informacionit. Ne po flasim për momentin tani. Dhe ne po  
10 flasim tani që të bëjmë një seancë *ex parte*, i kërkojmë pra  
11 Trupit Gjykes që të kemi një seancë *ex parte* për të dhënë  
12 informacionin e nevojshëm.

13 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Do t'ju japim leje për  
14 sesionin *ex parte* të cilin do ta fillojmë sa më shpejt të jetë  
15 e mundur.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

17 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Përpara sesa të largohemi nga  
18 salla në mënyrë që të përgatitet për seancën *ex parte* unë dua  
19 të jap disa urdhra me gojë, të cilët neve i përmendëm edhe  
20 përpara sa të përfundonim seancën e paradites.

21 Urdhri i parë është ky, siç e thamë dhe dje:

22 Mbrojtja e Gucatit urdhërohet që të japë një parashtrim  
23 me shkrim sa i takon sjelljes së procedurave lidhur me,  
24 d.m.th. ky është një parashtrim i cili duhet të bëhet deri më  
25 datë 3 shtator, 2021.

1 Ndërkohë që ZPS-ja urdhërohet që të bëjë parashtrimin me  
2 shkrim për klasifikimin e provave të drejtpërdrejta deri më 6  
3 shtator. Ndërkohë Paneli urdhëron Mbrojtjen që t'i përgjigjet  
4 mocioneve për paraqitjen e drejtpërdrejtë të provave, të  
5 provave materiale për Trupin Gjykes deri më 10 shtator.

6 Ndërkohë Mbrojtja duhet të parashtrojë parashtrimet e  
7 veta brenda limitit ose numrit prej 6,000 fjalësh. Ndërkohë që  
8 ZPS-ja do të duhet që të përgjigjet deri më 14 shtator, 2020.  
9 Pra ky është fundi i urdhrit të dytë.

10 Ndërkohë, sa i takon urdhrit të tretë. Më tej, Mbrojtja e  
11 Gucatit urdhërohet që të ofrojë jurisprudencë tjetër n.q.s. ka  
12 për sa i takon shtytjes për kryerjen e një veprimi penal të  
13 një krimi për një agjent provokues dhe gjithashtu të japë edhe  
14 parashtrime me shkrim të cilat kanë të bëjnë me përkufizimin e  
15 "interesit publik."

16 Nga ana tjetër i kërkon Mbrojtjes së Haradinaj që të  
17 japin parashtrimet e tyre për legjislacionin e Kosovës edhe  
18 çfarë parashikohet në këtë legjislacion, sa i takon njoftuesve  
19 të veprave penale dhe gjithashtu do të doja që të tërhiqja  
20 vëmendjen në draft transkriptin në faqen 476.

21 Parashikimet e përmendura më lart do të duhet të  
22 konsolidohen në një dosje për secilën nga skuadrat e  
23 Mbrojtjeve ndërkohë që numri kufi i fjalëve është 3,000.  
24 Parashtrimi duhet të bëhet deri më datë 6 shtator.

25 Ndërkohë urdhri i katërt është që paneli i Trupit Gjykes

1 e urdhëron ZPS-në që të shtojë një dëshmitar deri më 7 shtator  
2 2021, deri në orën 4. Ndërkohë, kërkesa nuk duhet të jetë më e  
3 gjatë sesa 3,000 fjalë. Në të njëjtën datë ZPS-ja urdhërohet  
4 që të nxjerrë material provues, të cilët kanë të bëjnë me  
5 dëshmitarin shtesë të propozuar.

6 Mbrojtja urdhërohet që të përgjigjet n.q.s. dëshiron ta  
7 bëjë këtë gjë deri në fund të konferencës për përgatitjen e  
8 ZPS-së.

9 Ky është fundi i urdhrit të katërt.

10 Paneli, Trupi Gjykses e urdhëron ZPS-në që të parashtrojë  
11 një kërkesë për shtimin e transkripteve të rishikuara deri më  
12 datën 13 shtator 2021.

13 Kërkesa nuk duhet të jetë më e gjatë sesa 3,000 fjalë.  
14 Deri në atë datë ZPS-ja urdhërohet që të nxjerrë materialet  
15 identifikuese përkatëse n.q.s. nuk e ka bërë këtë gjë.

16 Mbrojtja urdhërohet të përgjigjet n.q.s. dëshiron deri në  
17 20 shtator, 2021.

18 Ky është fundi i urdhrit të pestë.

19 Më tej sa i takon parashtrimeve të bëra dje, Trupi  
20 Gjykses urdhëron ZPS-në të parashtrojë mocionin e saj për sa i  
21 takon dëshmitarëve të Mbrojtjes edhe dëshmime të tyre, d.m.th.  
22 për heqjen e dëshmitarëve nga listat e Mbrojtjes, të cilat  
23 janë aktualisht të propozuara dhe këtë gjë ta bëjë deri më 15  
24 shtator.

25 Mbrojtja urdhëroi që t'i përgjigjet këtij mocioni të ZPS-

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 71

1 së deri më 27 shtator 2016 deri në orën 4.

2 Urdhri i shtatë.

3 Më tej, pra, sa i takon parashtrimeve të mbrojtjes të z.  
4 Haradinaj, Trupi Gjykses urdhëron një raport ekspertit dhe  
5 dëshmitarin e propozuar ekspert përkatësisht dëshmitarin 17,  
6 si pjesë e listave të dëshmitarëve të z. Gucati dhe të z.  
7 Haradinaj dhe këtë duhet që ta dorëzojnë më datën 1 tetor.

8 ZPS-ja urdhërohet që të parashtrojë një mocion sa i takon  
9 raportit të ekspertit brenda afatit kohor siç parashikohet nga  
10 rregulla 149(2) e rregullores. Pra, po ashtu, do të duhet që  
11 të parashtrihen dhe mocionet mbi bazën e rregullës 117 dhe  
12 mocionet do të duhen që të parashtrihen deri më 17 shtator,  
13 2020. Ndërkohë, është e rëndësishme që të shikohen gjithashtu  
14 edhe masat mbrojtëse dhe do të doja të thoja që Paneli sa i  
15 takon për masa mbrojtëse mohohet.

16 Urdhri i dhjetë.

17 Pra Trupi Gjykses i kujton palët për afatin kohor 3  
18 shtator, 2021 sa i takon çështjeve pezull për përkthim dhe  
19 verifikim të interpretimit drejtpërsëdrejti për Zyrën e  
20 Administrimit. Në qoftë se ka probleme në këtë drejtim do të  
21 duhet që të ngrihen menjëherë çështjet përkatëse.

22 Trupi Gjykses i kujton palët sa i takon procedurave të  
23 ndiqen, të cilat duhet të bëhen në përputhje me udhëzimet e  
24 punës për përkthimin dhe interpretimin të Zyrës së  
25 Administrimit si dhe të shërbimeve të verifikimit.

1 Për kërkesat për verifikim Trupi Gjykses i udhëzon palët  
2 që të ndjekin procedurat që janë të parashikuara në Udhëzuesin  
3 e Punës. Këto praktika do të duhet dhe udhëzime do të duhet që  
4 të respektohen në mënyrë rreptësore.

5 Dhe së fundi Trupi Gjykses planifikon konferencën  
6 përgatitore të ZPS-së më datë 8 dhe 9 shtator, 2021 në orën  
7 9.30. Tani do të bëjmë 30 minuta pushim në mënyrë që të mund  
8 të vijojmë më tej me sesionin *ex parte*.

9 Atëherë do vijojmë pas 30 minutash. Dhe do të kërkoja që  
10 të njoftoheshim sa më shpejt të ishte e mundur, ndërkohë që  
11 Mbrojtjes do t'i kërkoja që të qëndrojë në ndërtesë në mënyrë  
12 që juve të mund të njoftoheni menjëherë në momentin kur të  
13 përfundonte seanca *ex parte*.

14 Do të bëjmë pushim për 30 minuta.

15 --- Pauza fillon në orën 15.01

16 [Seancë *ex parte* gjendet në transkript më vete  
17 në faqet 73-99]

18

19

20

21

22

23

24

25



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore  
Konferencë përgatitore për gjykim (Seancë e hapur)

Faqe 100

1 --- Seanca rifillon në orën 16.44

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë!

3 GJYKATËSI SMITH: [Përkthim] Mirëdita! Jemi rikthyer në  
4 seancë të hapur. Për hir të procesverbalit kemi bërë diskutime  
5 *ex parte* me ZPS-në për listën e rregullës 102(3), dhe për këtë  
6 do të japim një urdhër gojarisht në këtë moment.

7 Ky është fillimi i urdhrit pasi shqyrtuam argumentet e të  
8 gjitha palëve përfshirë dhe ato të prezantuara nga ZPS-ja në  
9 seancën *ex parte*, Trupi Gjykses vendos që ta ndryshojë urdhrin  
10 e dhënë gojarisht më datë 1 shtator, 2021, që ZPS-ja t'i japë  
11 Trupit Gjykses vetëm listën e paredaktuar të rregullës 102(3),  
12 ku jep njoftimin e hollësishëm të materialit që bën të mundur  
13 marrjen e vendimit për materialitetin për Mbrojtjen.

14 Trupi Gjykses i jep urdhër ZPS-së që t'i japë përsëri  
15 vetëm Trupit Gjykses një version të propozuar të redaktuar të  
16 kësaj liste.

17 Të dyja këto versione duhet t'i dorëzohen Trupit Gjykses  
18 brenda datës 3 shtator, 2021 deri në orën 12.00.

19 Hapat e tjerë do të jenë siç përcaktohen nga Trupi  
20 Gjykses në konferencën përgatitore të ZPS-së që do të  
21 zhvillohet.

22 Këtu mbyllet ky vendim. Do të rimblidhemi ditën e mërkurë  
23 të javës tjetër. Këtu mbyllet seanca për sot.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë!

25 --- Seanca mbyllet në orën 16.47